

81H-2

1478

E reja e Kajo Gurrajt

DRAME



HAMZA
MINAROLLI

8JH-2

1478

HAMZA
MINAROLLI

E reja
e
Kajo
Gurrajt

(Dramë në dy akte)

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

4507

MINAROLI
HAMZA

Redaktor
ISUF NELAJ

Piktor
BESNIK TRUNGU

E reja
e
Kajo
Gurrajt

(Drame në dy akte)

Reçensues

Dhimitër Xhuvani

Kudret Velça

Naum Prifti

PERSONAZHET

- KAJAN (KAJO) GURRAJ — *plak rreth të 60-ave*
SABIKOJA *e shoqja*
QERIMI
HYSENI
HAMDIU *djemtë e Kajos*
GANIU
NAZMIJA *e shoqja e Qerimit dhe e
bija e Pashos*
BULJA *e shoqja e Hamdiut*
NETA *e shoqja e Hysenit*
PASHO PISHA *komandant çete balli dhe
babai i Nazmijes*
SELIMI *i biri i Pashos, partizan*
ALUSH AGO *ballist, mik i Pashos*
NURIU *i biri i Qerimit dhe Naz-
mijes*

MALIQI

vëllam i Kajos dhe krye-
tar i këshillit të fshatit Gu-
rraj

RAKIPI

hasm i Kajos

BEXHETI

i biri i Rakipit

IDRIZI

nip i Kajos

Fshatarë, partizanë, ballistë.

**Ngjarja zhvillohet në një fshat të Shqipërisë
Juglindore midis tetorit 1943 dhe marsit 1944.**

A K T I I

SKENA 1

Kajo Gurraj në dhomën e zjarrit. Është i menduar e pi duhan. Kohë mbrëmjeje.

KAJOJA — (*Monolog.*) Pse t'ia thotë kësaj së ardhure Pasho Pisha në këtë prag vjeshte?! Të ketë ndonjë hall kështu, apo si? S'ka mbushur muaji që thirri Qerimin. Tani na ngrihet e vjen vetë... (*Thërret të shoqen.*) Sabiko! Sabiko, moj!

SABIKOJA — (*Nga jashtë.*) Erdha.

KAJOJA — A është aty Qerimi, moj?

SABIKOJA — (*Nga jashtë.*) Këtu është, te dhentë.

KAJOJA — Thuaj të vijë këtu! (*Pauzë, me vete.*)

Dreq, o punë! S'të lënë rehat në hallet e tua, po na, të bëhet edhe krushku ballist e të ngrihet nga ana e anës e vjen e të ngatërron. (*Hyn Qerimi.*)

QERIMI — Më deshe, baba?

KAJOJA — E, të desha. (*Pauzë, Qerimi ulet.*) A nuk më thua për se vjen yt vjehërr sonte këtu?

QERIMI — Si or, për se vjen?!

KAJOJA — E, or, e. Për se vjen, po të pyes?!

QERIMI — Po për ty vjen, o baba. Ai të do e të nderon. Vjen edhe për Ganinë që u lirua nga burgu.

KAJOJA — Hë, e di, e di. Hëm... Jo po thashë, se mos ka ndonjë qëllim të prapë e ti e di e s'ma thua...

QERIMI — Qëllim të prapë ai ndaj teje?

KAJOJA — E de! Se ndryshe s'ka për se të vijë. Pasho Pisha e di që unë jam gjallë dhe mendtë në kokë i kam dhe më mirë se ç'e di unë se ku më pikon çatia, s'ka si ta dijë tjetri. Apo jo? Demek, ti s'di gjë pse vjen?

QERIMI — Unë e di që vjen për të mirë... për të të nderuar ty...

KAJOJA — Jo, po thashë, se ishe para ca kohësh andej e mos të tha gjë.

QERIMI — Tani, muhabet bëmë goxha atë natë, por...

KAJOJA — Lëri «poret» ti e më thuaj di apo s'di gjë pse vjen?

QERIMI — *(Me drojtje e me gjysmë zëri.)* Ç'dija t'i thashë.

KAJOJA — Ashtu de! Dhe dëgjo këtu. Ti je imbir dhe jo i Pasho Pishës. Dëgjove? Dëgjova, thuaj. Gjer më sot s'ma ka ngrënë qeni shkopin. Dhe as që ka për të ma ngrënë. Po hilet s'i duroj dot. Çdo hap me mend, se të kam të madhin. Ik tani te dhentë. *(Qeri-*

mi del dhe hyn Sabikoja, e hutuar diç kërkon.)

KAJOJA — Si u bë djali i Hysenit, moj? (*Sabikoja lëviz nëpër dhomë e diç kërkon.*)

SABIKOJA — E ka zënë gjumi, thotë nusja.

KAJOJA — Dëgjo këtu, ti! Djemtë s'i kam në shtëpi, prandaj gjersa të kthehen ata, nga ty dhe nga nuset dua që as gjembi të mos u hyjë në këmbë nipërve dhe mbesave të mia. Dëgjove? Dëgjova, thuaj! Ashtu de!

SABIKOJA — (*Gjithnjë duke ardhur vërdallë e duke kërkuar diçka e hutuar.*) E po fëmijë janë ata. Lozin e bredhin gjithë ditën. Edhe do të sëmuren ndonjëherë, edhe gjembi do t'u hyjë, ndryshe, s'rriten, po më lër rehat se s'po e gjëj...

KAJOJA — Ç'kërkon, moj, kështu si e shushatur, se na more mendtë?

SABIKOJA — Hapsin e sëndukut kërkoj.

KAJOJA — Po ja, moj, ku e ke, të plasën! Vetë e vure në kamare. (*Sabikoja merr çelësin dhe del me vrap.*) Dreq, o punë. Është bërë si e luajtur, sikur po vjen mbreti. (*Hyn Nazmija.*) Sa të kisha në mendje, moj bijë.

NAZMIJA — Urdhëro, baba!

KAJOJA — Para nja tri javësh tët shoq e thirri yt atë, Peshoja. Të tha gjë ç'e desh?

NAZMIJA — Tët biri s'para ia ka qejfi t'i zgjatë muhabetet me mua, baba, po zotrote ku të ha meraku?

KAJOJA — Kohët e fundit si shumë i kanë puqur
pipzat im bir me tët atë, Kjo s'më pëlqen.

Diç bluajnë, po s'di ku do t'i dalë tymi.

NAZMIJA — Siç më tha Qerimi një natë, Pashos
nuk i ka pëlqyer lënia e gjakut të Hysniut
për pas luftës...

KAJOJA — E çë pastaj? Pashos do t'i merrja lejë
unë?! Ai të lajë turpet e tij, se të miat i di
vetë.

NAZMIJA — Edhe tët bir, Qerimin, e ha ky me-
rak...

KAJOJA — Po, doemos. Më thuaj me kë rri, të të
them se cili je! (*Hyn Sabikoja.*)

SABIKOJA — Ngrehu, se erdhën. (*Nazmija del.*)

KAJOJA — Kush erdhi, moj?

SABIKOJA — Po krushku me Alush Agon, more,
kush tjetër. Ngrehu, de!

KAJOJA — Ku të vete, moj?

SABIKOJA — Si ku të vesh? Të dalësh të presësh
krushkun.

KAJOJA — Mirë jam këtu unë. Pse, pak jeni ju
poshtë për ta pritur?!

SABIKOJA — Po ai vjen për ty, more burrë...

KAJOJA — S'e dimë akoma se për kë vjen, jo.
Kur t'i nxjerrë këmbët, atëherë shohim e
bëjmë.

SABIKOJA — Pu-pu-pu-pu-pu! Pa ç'janë këto,
more burrë?! Të vjen krushku në shtëpi
e ti s'lëviz nga vendi!

KAJOJA — (*Ashpër.*) Këput qafën aty, se s'u bëre

ti të më japësh mend mua! (*Sabikoja merr e rregullon shiltetë e postiqet e dhomës.*)
Oj, sikur pō vjen mbreti e jo Pasho Pisha! (*Sabikos*). Dhe në daç ta dish, të mos ishte hatri i Nazmijes, që e kam më të mirën e nu-seve, zor se e prisja sonte.

SABIKOJA — E bën ti, e bën. Zaten tërë jetën çakmak ke qenë...

KAJOJA — Ashtu de! Jo po ta dish mirë! (*Ndihen këmbë në shkallë. Sabikoja del sakaq. Pas pak futen Pashoja, Alushi, Qerimi dhe Sabikoja. Kajoja u del në mes të dhomës.*)

PASHOJA — Mirë se të gjejmë, o Kajan Gurraj! (*Takohen.*)

KAJOJA — Ju qoftë këmba e mbarë! (*I takon atë dhe Alushin.*) Po pa lirohuni një çikë! Hë, Qerim, merrua armët e varua! (*Heqin armët, kollanët me fishekë dhe ulen nëpër vende.*)

PASHOJA — (*Pasi është ulur e merr kutinë që i zgjat Kajoja.*) Më kishte marë malli për ty, dhe sebeci i Ganiut pō ishte, po hë sot e hë nesër, gjer dje që e premë me Alushin. «Do vemi nesër, i thashë, dhe pikë». Telashe e punë plot, por edhe miqtë s'duhën harruar.

KAJOJA — (*Pasi i jep kutinë Alushit.*) Të drejtë ke, o Pasho, po ja që erdhën kohë të prapa e s'u duhet vënë re njerëzve. Ku ta dish si e kanë hallin. Unë, për vete, as jap, as kërkoj hesap se kujt i vete dhe kush më

vjen. Secili, si t'i bëhet më mirë, ashtu le të bëjë.

ALUSHI — E po edhe nga njerëzit s'ndahemi dot, o Kajo Gurraj.

KAJOJA — Zemra s'na e do të ndahemi, por, kur e do puna, edhe do të ndahemi, o Alush Ago.

PASHOJA — Zemrat t'i kemi të mira, pa punët i kemi në dorë vetë e i vërtitim si t'i duam.

KAJOJA — E ja, kjo s'dihet i vërtitim ne si t'i duam, apo na vërtitin ato ne, se ndryshe, o Pasho Pisha, (duke treguar armët) s'kishe pse të vije kaq i ngarkuar me hekura tek unë.

PASHOJA — (Që ia kupton romuzin.) Për armët e ke fjalën? E po rrugë e gjatë, o krushk. Rrugës po pyje me bisha... pastaj kohë të këqija, luftë hesapi.

KAJOJA — Sa për luftë, luftë është. Po pyjet ato që kanë qenë, ato kanë mbetur dhe rruga po ajo që ka qenë është edhe ne kemi çarë mes tyre dimër e verë me një sëpatë në dorë...

ALUSHI — Ke çarë, po ec e çaj tani? Kanë dalë ca bisha me dy këmbë tani, o Kajan Gurraj, që të hanë nga prapa.

KAJOJA — (Qerimit dhe grave.) Shtroni rakinë!

PASHOJA — Pse e nxiton rakinë? Të bënim edhe ca muhabet, pastaj...

KAJOJA — Muhabet do bëjmë dhe me raki ecën ca më mirë.

(Gratë shtrojnë sofrën, vendosin filxhanët, Qerimi i mbush ato me raki dhe pasi janë af-

ruar të gjithë e kanë zënë vend vë re mun-
gezën e Nazmijes.) Po Nazmija ku është? Të
vijë këtu!

PASHOJA — Më druhet mua, o krushk, se kemi
mbetur një çikë qejfprishur.

KAJOJA — Që kur kështu?

PASHOJA — Që kur më iku Selimi partizan. Të të
them të drejtën, më ha merakun se Nazmija
ia prishi mendjen.

KAJOJA — Lëri ato ti! Edhe në e pastë bërë atë
që thua ti, mirë e ka bërë.

PASHOJA — A jo, Kajo Gurraj!...

KAJOJA — Or, po kështu siç them unë! Mos m'i
bjerë në qafë nuses se e kam ajkën e nuse-
ve. Shiko mos është gjetiu e keqja. I bërë
me njerëzë fëmijët, Pasho. (*Hyn Nazmija.*)

NAZMIJA — Mirë se erdhe, baba! (*Ulet e përqa-
fon, i puth dorën.*)

PASHOJA — (*Pasi është përqaftuar.*) Mirë se të
gjeta moj bijë! (*Kajos.*) E ja, o krushk, s'u
bëka dot gjaku ujë. Evlati po evlat!

KAJOJA — Doemos. (*Grave.*) Hë, lëvizni! Sillni
ç'keni për të sjellë, se s'do t'ju presim juve!
(*Të trija nuset dalin. Sabikoja qëndron aty.
Kajoja merr filxhanin dhe uron.*) Ju qoftë
këmbe e mbarë! Gëzuar!

PASHOJA — (*Duke e përplasur filxhanin.*) As që-
parë, as tani s'na the «Mirë se erdhët», o
krushk. Pse kështu?

KAJOJA — Është ca më i mirë ky urimi ynë, o

Pasho Pisha. Fjala e mirë e ka radhën në fund. Po që këmba e mbarë dhe qëllimi i mirë, të tëra mirë e mbarë venë. Ja, gëzuar! (Përplas filxhanin.)

PASHOJA — (Duke përplasur filxhanin.) Mirë se ju gjetëm dhe shyqyr që ju erdhi Ganiu shëndoshë! Gëzuar të gjithëve! (Ganiut.) Të shkuara, Gani! Dhe, dëgjo Pashon, me mend, me mend, bir. Se ashtu siç u kape ti, or bir, me armë e me trakte, zor se i shpëtoje plumbit.

GANIU — E po luftë është o zoti, Pasho. Dikush edhe do të vritet, ndryshe nuk çlirohemi.

PASHOJA — Jo, bir, jo. Le të vriten ata që u ka marrë koka erë. Ne jemi nga ata që duam mishi të piqet, po helli të mos digjet.

ALUSHI — Se s'ia dalim dot me gjermanin, or jo!

KAJOJA — Kështu thoshin ca edhe për Italinë, o Alush, po fundin ua pamë italianëve, se.

ALUSHI — Se mos e mundëm ne Italinë.

KAJOJA — Aq sa na takonte dhe sa mundëm, ne e bëmë, o Alush. Që ditën që shkeli e gjersa kapitulloi, s'ia ndamë pushkën.

PASHOJA — Gjermani ka punën e tij. S'të nget, mos e nga. Pse e kërkon belanë me para?!

KAJOJA — Ej! Ai të, vijë këtu, të vrasë, të djegë, të burgosë e të bëjë si i do qejfi e ti t'i thuash «më rrofsh, o gjerman»?! Jo, ore, pushkën qenit! Ç'punë ka këtu e kush e ftoi?

PASHOJA — Luftë Botërore kjo, o krushk, dhe

Fuqitë e Mëdha, që luftojnë me njëra-tjetrën, kështu e kanë. Hyjnë kudo që ua do puna. Po pse, ore, a s'të hyri në Luftën e Parë Austria, e Franca, e Italia, e Greku, e Sërbi...

KAJOJA — Hynë, o posi, se atëherë s'kishte kush t'i dilte zot këtij vatani. Tani që kemi, aha! Harro mushkë Valarenë!

PASHOJA — Më duket se qenke bërë i tëri «i kuq», o krushk.

KAJOJA — S'di në jam bërë vërtet «i kuq» apo jo, por di që i zi as jam bërë, as kam për t'u bërë, o Pasho Pisha.

PASHOJA — (E kapërcen.) E di që e ke mirë. Mor po ty të lumtë! Je burrë me mend. Di dhe i vërtit punët: edhe me ne, edhe me të kuqtë. Dhe mirë bën. Luftë kjo e s'dihet si venë punët...

KAJOJA — Nuk ta mora vesh atë fjalën që the: edhe me ne, edhe me të kuqtë... Që të dy djemtë, Hysenin dhe Hamdinë, i kam partizanë, këtë e di, por...

PASHOJA — Tani rregullo dhe krahun tjetër... dhe...

KAJOJA — E si, demek?

PASHOJA — Burrë me mend je, o Kajo Gurraj, e kaq duhet ta dish që në këtë luftë s'dilet pa lagur. Puna është të mos mbytesh. Kaq të them unë, si mik i kësaj shtëpie.

KAJOJA — Po zotrote ç'mendjeje i bëre hyzmet

që u krodhe i tëri me Ballin? Mos të mban shpresa e Selimit kështu?

PASHOJA — Hiç, fare! E di që kuqalashët s'falin njeri...

KAJOJA — E po atëherë?

PASHOJA — Zotrote e di, o Kajo Gurraj, që kjo e shkretë botë që kur është krijuar njësoj ka qenë, njësoj ka mbetur e do të mbetet: fukaraja përpiqu e lufto, paria fito e sundo. E vrava mendjen dhe vendosa: «Pasho! — i thashë vetes, jo gjithmonë me të mundurin ti! Dil një herë me të fituarin». Dhe, siç më sheh, mora krahun e parisë.

KAJOJA — E po kësaj here s'i dihet si del hesapi, o Pasho!

PASHOJA — I dihet, i dihet, Kajo Gurraj! Deti kos të bëhet e lug për fukaranë s'mbetet, or jo. Do sillet nga të sillet puna, e prapë paria që paria do të dalë në krye.

KAJOJA — Ej!

PASHOJA — Kështu, o po si. Vërtet këta çunakët e axhaminjtë kanë marrë një çik yrysh e duket sikur do ta fitojnë davanë, po prit, se është shpejt. E ka bishtin prapa dardha, vëlla. S'ka nisur gjermani, ashtu siç duhet, pa, kur të nisë, s'do gjejnë vrimë ku të futen e do mallkojnë sahatin që lindën! Dëgjo Pashon ti. Prandaj të erdha si mik dhe po ta përsëris që në këtë luftë duhen vërtitur mirë punët, duhen pasur të dy krahët të ngrohtë, se s'dihet fundi i saj.

KAJOJA — (Ngacmueshëm.) E si, demek? Pa, hë!

PASHOJA — Hysenin dhe Hamdinë andej, Qerimin do të ma japësh mua dhe rregullohet një herë e mirë kjo mesele.

KAJOJA — (Prerë.) Pse për këtë qenke lodhur zotrote?

PASHOJA — E po... ç'thamë deri tani. Për të mirën tuaj e bëj.

KAJOJA — Si vonë ia nxore kokën muhabetit, o Pasho Pisha. E paske pasur më të madh hallin sesa mallin.

QERIMI — Po dale, o baba, se .. (Hyn Nazmija e ulet pranë Sabikos).

KAJOJA — (Prerë) Ka radhë fjala. Kur flet babai, i biri bën mirë të dëgjojë. Ashtu de! (Pashos.) Unë s'kam djalë për të të dhënë me vete, o Pasho Pisha. Më duhen djemtë, se vetë u plaka dhe jam shtëpi me halle.

PASHOJA — Që je shtëpi me halle, këtë e di...

KAJOJA — E po në e di, atëherë...

PASHOJA — Unë s'desha të ta hapja këtë plagë, o Kajo Gurraj, sepse e di që dhemb.

KAJOJA — Dhemb e dhemb shumë... —

PASHOJA — Po meqë e hape vetë, do t'i them edhe unë dy fjalë. Se me cilët bëhesh ti, me të kuqtë apo me ne, kjo është puna jote, veçse Rakip Çezma, ai që vrau tët bir, Hysninë, e fshehu kokën, me gjithë djemtë, te partizanët dhe...

KAJOJA — Këtë e di...

PASHOJA — E po në e di, ti je burrë zakoni, dhe një krahinë e tërë të mban për burrë me mend, trim dhe të ndershëm. Do ilaç ajo plagë që të mbyllet, ndaj e dua Qerimin me vete.

KAJOJA — Dëgjo këtu, ti Pasho Pisha! Në ke ardhur si mik e krushk, rri siç duhet ndenjor, që të të bëj nderet që të takojnë. Unë pazarlleqe me nderin tim as kam bërë, as bëj. Një kjo. E dyta, gjaku i tim biri më takon mua dhe jo ty. Edhe sikur të vdes unë dhe djemtë e mi, ka Kajoja një dynja me nipër e një fis të tërë Gurraj. Dhe e fundit, Rakip Çezma s'ka ku të më fshihet. Lufta një ditë do të mbarojë e ai edhe në bri të buallit të futet, unë do ta gjej. Ashtu de!

PASHOJA — Po në e fitofshin luftën të kuqë, e di ti që Rakip Çezma të kthehet me pallaska mbi supe, të bëhet zot i krahinës e ti s'ke ç'i bën më?

KAJOJA — Mbret s'qenka bërë, plumbit tim s'i shpëton dot, or jo.

ALUSHI — Po ç'e do që komunistët kanë bërë pajtimin e gjaqeve se.

KAJOJA — Po. E kanë bërë, por ama derisa të mbarojë lufta. Edhe unë për aq e kam dhënë fjalën.

QERIMI — Po nesër ta dredhin prapë ata, o baba.

KAJOJA — Atëherë nesër shohim e bëjmë.

PASHOJA — Prandaj unë them që Qerimi të vijë me mua, se kështu edhe gjakut do t'ia

gjenim rastin pa derman dhe do ta merrnim,
edhe ti do të ishe më të dy krahët i ngrohtë.

KAJOJA — Ta thashë një herë që me hallët e mia
dhe me nderin tim nuk bëj pazarllëqe.

PASHOJA — Po duhen bërë, mor i uruar, duhen
bërë, se është luftë e ngatërruar kjo e sot-
mja....

KAJOJA — Lufta ka punët e saj, unë të miat,
prandaj t'i biem shkurt, Pasho Pisha. Unë
djalë për t'i dhënë Ballit s'kam.

PASHOJA — Demek dy djemve të tjerë ti ua paske
dhënë lejën për të dalë partizan?

KAJOJA — Po, doemos që unë. Edhe Ganiu, ta-
ni që doli nga burgu, atje do të shkojë.

PASHOJA — Po pse s'e çon tek unë Ganinë. Ti e
di që tek unë s'e prek as miza.

KAJOJA — Atje do, Pasho Pisha, pastaj që të ta
tthem troç, mua këto punët e Ballit as më
janë dukur, as më duken të qëruara. S'dua ta
mbyll me turp në pleqëri.

PASHOJA — (I nxehur:) S't'i pata borxh këto që
më the, o Kajo Gurraj.

KAJOJA — I kam sahanët pa kapak, Pasho Pi-
sha. Unë kështu i gjykoj punët. Ç't'u desh
ty Balli more, apo se të yshti Isuf beu, ë?
T'u duk gjë e madhe kjo sajdisje dhe mbylle
sytë e dalldise pas tij. Ai të sajdis se e ka
litarin në grykë, e ti, në vend që t'ia shtrën-
gosh edhe ca, vete m'...

SHKURTET 17
45071

PASHOJA — (*Brof në këmbë.*) E po kështu s'duroj dot unë, o Kajo Gurraj. S'më nxë vendi.

KAJOJA — (*Ngrihet dhe ai në këmbë.*) Në s'të nxë, gjeje vendin, o Pasho Pisha, se këtu vërtet je shtrënguar.

PASHOJA — Demek edhe po më përze, ë? (*Ngrihet dhe Alushi.*)

KAJOJA — Me këto mend, do kishe bërë mirë të mos ishe nisur fare për këtu.

PASHOJA — (*I nxehur.*) Armët! Më jepni armët. (*Nazmija i del përpara.*)

NAZMIJA — (*Duke i dhënë armët.*) Ç'kërkon të bësh?! Mblidh mendtë! Baba Kajoja ka të drejtë. E ngave atje ku s'mban..

PASHOJA — (*Nazmijes.*) Hiqmu sysh ti! (*Kajos.*) S'ta pata borxh këtë që më bëre, o Kajan Gurraj. Të erdha si mik e si mik t'i qava halllet. Po ti më prite me këmbët e para. (*Niset të ikë.*)

KAJOJA — Se deshe të më kafshoje, prandaj. (*I pret udhën.*) Prit se t'i kam edhe dy fjalë. (*Pashoja qëndron.*) Ç'pate me tim bir, Qerimin?

PASHOJA — Kërkova hisen time.

KAJOJA — Po t'u desh ajo hise që ke, merre dhe na lër rehat.

PASHOJA — Do të piqemi prapë, o Kajan Gurraj, dhe do të ma kesh nevojën.

KAJOJA — Kurrë! E dëgjove? Kurrë, po të them!
(*Dalim Pashoja, Atushi dhe Qerimi.*) Prapa
diellit shkofsni!

SABIKOJA — (*Tepër e shqetësuar.*) Pu, pu, pu, pu!
Po ç'bëre kështu, mor.

KAJOJA — Mbylle!

NAZMIJA — Mirë ia bëri. Ashtu e donte.

KAJOJA — E dëgjon?

SABIKOJA — Po ç'të dëgjoj, mor...

KAJOJA — Mbylle po të them!

SABIKOJA — Si ta mbyll, kur ti më përze krush-
kun nga shtëpia?! Ku është parë e dëgjuar
kjo që bëre ti sonte?

KAJOJA — E po në s'është parë e dëgjuar, do
të shihet e dëgjohej sot e paskëtaj, Ja që
nisi këtu, në shtëpinë e Kajan Gurrajt.
(*Nazmijes.*) Shko, bijë, shko, se mos të grind
Qerimi. (*Nazmija del.*)

SABIKOJA — Pu, pu, pu, ... Turp, turp, turp!

KAJOJA — Mbylle gojën e thyej qafën, se të du-
rova shumë! (*Sabikoja del.*) Oj, rrufjani!
Vjen të më bëjë lëmsh shtëpinë. Siktersi!
(*Errësohet skena, ndriçohet paraskena
oborr. Duke dalë Pashoja, Alush Agoja, Qe-
rimi dhe më pas Nazmija.*)

PASHOJA — (*Ndalet e i drejtohet Qerimit.*) —
Të thashë që s'merr të çarë yt atë. Sa më
prishe me të kot.

QERIMI — S'ma mori mendja se vinte puna gjer
këtu, jo!

PASHOJA — Tani mblidhe mendjen dhe vendos.

NAZMIJA — Ç'të vendosë?! I ati ia tha prerë.

Pastaj ai ka grua e fëmijë.

QERIMI — Ti mbylle aty e na lër rehat! E di unë atë punë!...

PASHOJA — (*Nazmijes.*) Mirë të thotë, mbylle ti! (*Qerimit.*) Në ke ndër mend ta lash turpin e të qetësosh shpirtin për tët vëlla, rrugën e ke të hapur.....

NAZMIJA — Lëre rehat Qerimin, baba!

QERIMI — (*Nazmijes.*) Këput qafën ti, se më ka ardhur, ja, këtu! (*Nazmija futet brenda.*)

PASHOJA — Në do fjalën time, unë të them mos e zgjat. Megjithatë, mendohu sonte. Ne na ke të Lamja. Nesër do të nisemi pa gdhirë,

ALUSHI — Vetëm një çikë burrëri duan këto punë, o Qerim...

PASHOJA — Burrë e kaluar burrit është ai, o Alush! S'është nga ata që e hanë turpin me bukë jo. Ke për ta parë e njohur, Ja, natën e mirë!

QERIMI — Natën e mirë! (*Ata ikin, Qerimi futet brenda, Errësim. Sipari.*),

SKENA II

Po ajo dhomë. Që jashtë dëgjohet zëri i Kajos që thërret e shan.

KAJOJA — *(Nga jashtë.)* Këput qafën ti! Mjaft më dërdëllite! *(Duke hyrë.)* Një bukë që thyhet, s'ngjitet më. Ai me mua as me gjallje, as me vdekje s'piqet më! E kam bërë lanet. *(Sabi-koja i vete nga pas e ai ulet.)* Ai s'është më im bir!

SABIKOJA — Po mirë, mor i uruar, mirë. Të drejtë ke, po mos thirr kaq shumë, se dëgjuan fqinjët.

KAJOJA — S'paska dëgjuar gjithë fshati. Pse, moj, mbulohet dielli me shoshë?!

SABIKOJA — E mirë, de, mirë veç ule zërin!

KAJOJA — Nuk e ul, jo. Do thërras sa të çahet tavani dhe muret bashkë, se këtë që më bëri ai, s'e gëlltit dot unë, jo. Edepsëzi! Me kokë të tij ai tërë jetën.

SABIKOJA — E di, po pse m'i thua mua?

KAJOJA — Që ta dish e ta njohësh ç'djalë ke...

SABIKOJA — Unë e njoh, po ti a e njeh tët bir?

KAJOJA — Unë s'e kam bir.

SABIKOJA — E mirë, de, mirë. Të flet inati pa... gjaku s'bëhet ujë.

KAJOJA — Oj, s'bëhet, thotë! Bëhet e djalloset fare! Dhe ti mos më dërdëllit shumë mua,

se më ka ardhur ja, këtu! (Vë dorën në majë të hundës.)

SABIKOJA — (Për ta qetësuar.) Të drejtë ke, por...

KAJOJA — E po në kam të drejtë, mbylle dhe shko e më thirr nusen e atij lanetit.

SABIKOJA — Po ç'faj të ka ajo e zezë?!

KAJOJA — Atë e di unë. Ti bëj si të thonë!

SABIKOJA — E mirë, de, mirë. Po ta thërres. (Del.)

KAJOJA — Edhe kjo m'u desh tani në pleqëri. Sikur të mos mjaftonin hallet që kam, na edhe laneti ma bën këtë proçkë dhe ma lë në derë. Ec e laje këtë turp! (Hyn Nazmija e heshtur dhe kokulur.) Pa ulu aty, ti! (Nazmija ulet në gjunjë.) A nuk më thua, kush e gatoi këtë farë çorbe të ndyrë, që ma vutë përpara për ta ngrënë? Kush?! Yt atë apo ti?

NAZMIJA — Im atë dhe yt bir, baba.

KAJOJA — Jazëk u qoftë të dyve! Po ti, s'di asgjë?

NAZMIJA — Asgjë, veç atyre që di zotrote.

KAJOJA — Vërtet s'të tha asgjë yt atë e yt shoq?

NAZMIJA — Për atë perëndi dhe mos i paça fëmijët që mua s'më thanë asgjë. Sot, ndaj të gdhirë, Qerimi më zgjoi e më tha t'i bëja pak bukë të hante. Duke ngrënë më tha: «Unë do të iki me tët atë që të marr gjakun e Hysniut. Ti kujdes fëmijët!»

KAJOJA — (*Shpërthen.*) Gënjen qeni! Gënjen ditën në drekë! Këtë e bën Pasho Pisha të më njollosë, dhe ai i shkoi pas.

NAZMIJA — I fola sa munda, po ishte e kotë. Ai u mat të më rrihte. Ndaj në të ikur më tha: «E di që babai do të më shajë, po ti mos u mërzit, se një ditë edhe ai do të zbutet, kur t'ia shohë hairë kësaj që po bëj sot!»

KAJOJA — (*Brof në këmbë.*) Edhe këtë e paska thënë qeni? Po ai e di mirë cili është Kajo Gurraj. E di edepsëzi, që ky Kajan Gurraj e ka dhënë një herë fjalën para gjithë krahinës dhe dysh s'e bën sikur të bëhet ki-
ameti! (*Hyn Ganiu.*) Po ç'u bëre, more bir?! E more vesh ç'na bëri....

GANIU — (*I mërzitur.*) E mora, baba, e mora. Pastë faqen e zezë!...

KAJOJA — Po, ç'e do që na nxiu edhe ne, mor bir.

GANIU — Vetes ia bëri. Merre më urtë, baba! Një degë e tharë është ai. Do ta presim që në rrëzë atë degë. Lisin e kemi të fortë me rrënjë e me degë.

KAJOJA — E, mor bir, e, po bota atë degë të tharë të tund para turinjve, se!

GANIU — E po ndonjë shok i Pasho Pishës edhe atë degë mund të na tundë, o baba, po kjo Parti s'shkon pas llafeve të botës. Ajo di të ndajë mirë shapin nga sheqeri.

KAJOJA — (*Duke treguar Nazmijen.*) E po, po hëngri kjo bukë në një sahan me mua, nuk ndahet kollaj shapi nga sheqeri, or jo!

GANIU — Ç'ke ndër mend të bësh, baba?!

NAZMIJA — (*E ngashëryer.*) Baba, për kokën e fëmijëve, unë s'të kam asnjë faj!

KAJOJA — Koha do të na e tregojë. E bija e Pashos je dhe ti. Mos të duket e pakët kjo?

GANIU — Por është edhe motra e Selimit, o baba...

KAJOJA — E di...

GANIU — E po në e di, le ta bisedojmë një herë edhe me xha Maliqin.

KAJOJA — Kam mendtë e mia e ato më mjaftojnë.

GANIU — Po e ke byrazer, o baba, pastaj e kemi edhe kryetar të këshillit...

KAJOJA — Në shtëpinë time vendos unë e jo këshilli. Ashtu de.

GANIU — Unë them ta mendosh mirë këtë punë, baba.

KAJOJA — E kam menduar. (*Nazmijes.*) Ti ç'ke vendosur?

NAZMIJA — Tek im atë nuk shkoj as e gjallë, as e vdekur! Nderi im dhe i fëmijëve të mi është këtu, në këtë shtëpi!

KAJOJA — Kështu e ke prerë?

NAZMIJA — Prerë jo, po kështu mendoj. Megjithatë, unë kam një vëlla, Selimin. Dua ta rrah edhe me të një herë këtë punë.

KAJOJA — Ta rrahësh, posi, por, ama, unë e dua të prerë. O këtu e sahanët veç, o tek yt atë!

NAZMIJA — Nuk të duket se po më rëndon shumë?...

KAJOJA — Hakën po të hap....

NAZMIJA — E po unë e bija Pashos isha edhe dje....

KAJOJA — Ishe posi, po ja që sot u bëre dhe e shoqja e lanetit. E di këtë ti?

NAZMIJA — E di, posi, po ai lanet është më tepër yt bir se im shoq...

GANIU — Mirë të thotë, baba...

KAJOJA — Ç'mirë thotë, more?! Mbylle ti!

NAZMIJA — E po dije, baba, se unë në këtë shtëpi kam qëndruar më shumë për hatrin tënd, se sa për hatrin e tim shoqi. (*Ul kokën e turpëruar.*)

KAJOJA — Eu! E pse s'ma ke thënë këtë?!

NAZMIJA — Sepse ishin boll ato halle që kishe... s'doja të t'i shtoja...

KAJOJA — Demek ia ke njohur maskarallëqet tët shoqi?

NAZMIJA — Ca më tepër sesa ti tët biri. Shpirti im e di. (*Përlotet.*)

KAJOJA — E po e sheh?! Ku e di unë se ç'proçkë tjetër bën ai me tët atë?!

NAZMIJA — Ata mund të bëjnë çdo gjë, po unë jo. Unë kam nderin dhe emrin tim...

KAJOJA — Do të bëhet siç thashë dhe pikë! Në vendose të rrish këtu, të rrish. Unë në rrugë të ma-

dhe s'të hedh dot, po sahanët veç. Nga ty dua që fëmijët të m'i mbash e të m'i rritësh mirë. Kjo e para. E dyta, ti do të vesh te konakët dhe do të zësh dhomën e madhe dhe hashefin. Këtej s'ke punë as të hysh, as të dalësh! Për ç'të duhet, që nga drutë, mielli, kripa,.. e gjer me pe e me gjilpërë do t'ia kërkosh sat vjehrrë. Fëmijët po fëmijë janë, edhe do të vijnë këtej.

NAZMIJA — (*Gjithë ngashërime e me lot.*) Më rëndove shumë, baba!

KAJOJA — Tani kështu u vendos e kështu do të bëhet. Koha do të na mësojë si do bërë më mirë. Ashtu de!

NAZMIJA — Në ta do nderi i kësaj shtëpie, hidhma këtë barrë mbi supe... ndryshe...

KAJOJA — Edhe shpirti edhe nderi i kësaj shtëpi këtë kërkojnë. Kaq kisha. (*Nazmija del e këmbëhet me Sabikon që hyn.*)

SABIKOJA — Po vjen Maliqi.

KAJOJA — Mirë se të vijë! (*Sabikoja del.*) Hajde, or hall, hajde! Ec e të ta nxjerrë goja e t'ia thuash Maliqit këtë turp! (*Hyn Maliqi e Sabikoja.*)

MALIQI — Ja, vdekje fashizmit, Kajo, e mirë se të gjeta!

KAJOJA — Liri popullit dhe të lumshin këmbët! Mirë se më erdhe! (*Takohen me Maliqin*)

- Po ç'e do, o Maliq, s'më gjete hiç mirë.
(Ulen të gjithë.)
- MALIQI — (Sabikos.) Ç'thotë plaku kështu, moj Sabiko, shëndoshë si molla e thotë s'jam mirë-ë! Apo të përkëdhelet ty?
- SABIKOJA — Jo, or Maliq, jo. Sot vërtet s'jemi mirë. Na ka ndodhur një hata e madhe që s'e dimë veten ku jemi.
- MALIQI — Po ç'paska ndodhur kështu?! Qenkam nxituar, si duket?!
- KAJOJA — Ke ardhur tamam në kohë, sikur të të kisha thirrur.
- MALIQI — Ke nevojë për ndonjë ndihmë? Fol! Mos më kurse!
- KAJOJA — Ç'ishte për t'u bërë u bë, o Maliq.
- MALIQI — E po mjaft më le në errësirë, de! Thu- amë ç'ka ndodhur?!
- KAJOJA — S'ma nxë goja, jo...
- MALIQI — Mos ju ka ndodhur gjë, ndonjë vdekje, kështu?
- KAJOJA — Ku ta gjeja, kapak floriri përpara kë- saj që ndodhi.
- MALIQI — Ej! E po nxirre, de!
- KAJOJA — Qerimi, ai lanet, që iu harroftë emri, më iku sot me Pasho Pishën.
- MALIQI — Mos! Më dogji ardhja e Pashos! Ta thashë...
- KAJOJA — Ma the vërtet, po gjer këtu s'ma mori mendja.

MALIQI — (Serioz) S'duhej të të ndodhte ty kjo,
o Kajo!

KAJOJA — Lëre, lëre, o Maliq më njolloosi për
tërë jetën!

MALIQI — Jo deri atje xhanëm se Kajo Gurrajn e
njohin mirë të gjithë dhe e dinë ç'burrë
është, por kjo s'duhej të të ndodhte tamam
ty.

KAJOJA — Kjo ndodhi o Maliq, dhe ndodhi për
të më turpëruar mua. Tani as më thua, të
nisem tani e të vete ta gjej atje ku është e
ta vras në vend atë dhe Pashon bashkë?
Thuamë po dhe u nisa.

MALIQI — Je në vete?! Hiqe nga mendja këtë!
Po bërë këtë u prishe me Partinë.

KAJOJA — Ej! Po pse, ore, kaq iu dhimbska Par-
tisë gjaku i Qerimit dhe i Pasho Pishës?!

MALIQI — S'ka punë dhembshurie këtu, jo, por
ne do të veprojmë ashtu siç na e do puna.
Tani që erdhi gjermani, gjakosja me Ballin
është punë me sot e me nesër, po shkaktarë
s'duhet të jemi ne. Kur ta nisin ata, do t'ua
vëmë festen tamam sipas kokës.

KAJOJA — Po gjer atëherë unë ç'të bëj? S'më
mban vendi. A të vete në batalion te djemtë?
Ç'thua?

MALIQI — (Qesh me përzemërsi.) Ama, llaf the!
Ore, Luftës sonë nuk i duhen njerëz vetëm
në batalione e brigada, por edhe në fshatra
e qytete. Apo jo, o Gani?

GANIU — Ashtu është, xha Maliq!

MALIQI — Se po ikët ju të gjithë malit, me kë do të më lini mua dhe shokët? Edhe ne për Luftën punojmë dhe, që ta dish, pa këtë punë, Lufta jonë merr fund!

KAJOJA — E po si atëherë?

MALIQI — Çfarë?

KAJOJA — Si lahet ky turp?

MALIQI — Duke qëndruar siç ke qëndruar deri më sot.

KAJOJA — S'është mjaft kjo, jo. Folmë hapur mua! Ashtu de!

MALIQI — Dëgjo këtu, o Kajo. Kurr të thashë se kjo s'duhej të të ndodhte ty, nuk e kisha fjalën që këtë e bërë ti, së unë e shokët e mi e njohim mirë Kajo Gurrajn, e njeh një krahinë e tërë, ore! Fjalën e kisha që kjo që ndodhi s'duhej t'i kishte ndodhur tamam Kajo Gurrajt. Ndonjë tjetri mundej, por jo ty. Kështu, o Gani?

GANIU — Mirë e the, xha Maliq.

MALIQI — Tani ti je bërë pikë e vrer. Të drejtë ke. S'është e paktë, por, ama, s'jam në një mendje me ty kur thua se të njollosi e të la me turp për tërë jetën. S'është tamam kështu. Ai, në radhë të parë, njollosi e turpëroi veten, pastaj edhe ne të tjerëve s'na la pa gjë fare, jo, se përgjegjësi për këtë që bëri Qerimi yt s'ke vetëm ti, ore, po edhe ne. Ashtu de! T'i themi gjërat ashtu siç

janë. Tani kjo ndodhi edhe ti duhet ta mbash veten. Të gjithë e dinë kush është Kajan Gurraj. Ishte dera e Kajo Gurrajt ajo që u hap e para për partizanët dhe ishte po Kajo Gurraj i pari që u lidh me Partinë e që i dha besën asaj; i pari që la mënjanë zakonin e gjakut, edhe pse plagën e kishte të re; të parët djemtë e Kajos që dolën mahlit. Të gjitha këto s'janë të pakta. I dinë njerëzit të gjitha. Ti të vazhdosh si ke vazhduar. Unë kështu gjykoj.

GANIU — Mirë thotë xha Maliqi.

MALIQI — Kështu, o posi! Ti po me Qerimin do-emos të prera punët!

KAJOJA — Të prera the?! Të prera e të djallosura në këtë dynja dhe në atë dynja. Veç e kam edhe një frikë, o Maliq, se mos më turpërojë edhe më shumë.

MALIQI — E mora vesh. Të drejtë ke. Ajo s'duhet të ndodhë, Kajo,

KAJOJA — Po si t'ia bëj se? Se mos e kam këtu e ta bëj zap.

MALIQI — Ta mendojmë këtë. Do merrem unë me këtë punë.

KAJOJA — Se ndryshe, pastaj s'e mban vendi Kajanon. Ujë të zi do nxjerrë.

MALIQI — Jo ashtu, de! Ç'do gjë do bërë me mend e me gjakftohtësi. Kjo që të ndodhi ty me Qerimin s'është as rasti i parë, as rasti i fundit, ore! Në këtë luftë biri ngrihet kundër tet,

ashtu si i ati kundër të birit e së bijës, vëllai kundër vëllait. Shkurt hesapi, Kajo, në këtë luftë secili ka vendin e tij dhe gjykohet e çmohet për atë që bën vetë. Kështu do parë kjo punë.

KAJOJA — Mirë thua ti, o Maliq, po ç'e do që mua kjo plagë do të më sëmbojë për tërë jetën. S'di ç'të bëj e si të sillem.

MALIQI — Urtë, sa më urtë e gjakftohtë. Këtë të bësh...

KAJOJA — Do ta nis edhe Ganiu në batalion. Atje me të vëllezërit edhe ky.

MALIQI — I ke dy djem në batalion. Hë për hë, boll janë. Pastaj Ganiu të duhet ty, o lumëmadh, se u plake.

KAJOJA — Kështu si rodhën punët, o Maliq, edhe 12 djem të kisha, të 12 në batalion do t'i goja (*Ganiu*.) Ç'thua ti, mor bir?

GANIU — Fjalën tënde prisja, baba.

KAJOJA — E po në prisje fjalën time, të marrë e ke. U vendos kjo! (*Ganiu ngrihet e del dhe ai. Maliqit.*) Nuses së atij lanetit ia preva: o tek i ati, o këtu e sahanët veç e veç.

MALIQI — Thua të këtë gisht edhe ajo në këtë punë?

KAJOJA — Ajo bën be e rrufe që jo, po se ç'fsheh njeriu nën lëkurë s'e merr dot vesh lehtë. Të rëndë e pata boll, por s'e honepsja dot, pastaj me të parë e me të bërë, Maliq.

MALIQI — Ti i di vetë këto punë, o Kajo. Janë njerëzit e tu e sa i njuh ti, si njuh kush.

KAJOJA — E kishna nusen më të mirë, në daç për punë, në daç në pritje e për përcjellje, në daç për mend e në daç për trimëri, po ç'ti bëj, e djallosi i ati bashkë me lanetin tim, (*Hyn Hamdiu partizan. Kajoja habitet e gëzohet.*) Oj! Po ti nga na mbive, mor bir?! Mirë se më erdhe! (*Takohet me të birin, pastaj Hamdiu takon Maliqin dhe ulet.*) Po çfarë e mirë të solli? Zbritët të tërë këtej?

HAMDIU — Jo, baba. Unë i mora leje komisarit, se...

KAJOJA — Se more vesh proçkën e tët vëllai kë shtu, a si?

MALIQI — Lëre djalin të ta thotë «psenë», o Kajo!

KAJOJA — Pa hë, mor bir, si është puna? Ke ndonjë hall kështu, a si? Hyseni si është?

HAMDIU — Të bën të fala. Mirë është, mirë.

MALIQI — (*Matet të ngrihet.*) Unë po dal, o Kajo. Hamdiu ka ardhur për një hall. Dëgjoje mirë e jepi rrugë punës!

KAJOJA — Po ti gjersa e ditke që ka ardhur për hall, duhet ta dish edhe hallin.

MALIQI — E di, posi. Mbrëmë erdhën e ma thanë, ndaj të erdha edhe unë, po si të gjeta det me hallin e parë, thashë të mos të të ngarkoj më tepër.

- KAJOJA — O po thuajeni ç'është për të thënë!
- MALIQI — Ja të të thotë Hamdiu. (*Ngrihet.*) Unë po iki që ta kuvendoni vetëm atë e bir.
- KAJOJA — Ulu, aty, ulu! Gjersa e ditke, s'ke pse ikën. Ja ta dëgjojmë e ta kuvendojmë të tre.
- MALIQI — Ç'thua, o Hamdi?
- HAMDIU — Ulu, ulu, xha Maliq, se tri mendje gjykojnë më mirë se dy.
- KAJOJA — Mirë të thotë! Ulu, de! (*Maliqi ulet.*) Pa hë, mor bir, fol!
- HAMDIU — (*Heziton.*) E di si është puna. baba.,, (*Ngec.*)
- KAJOJA — Mor, po ç'ke kështu ti, ngërçi të ka zënë që të ngec fjala në grykë?!
- MALIQI — E di si është puna, o Kajo. Hamdiu yt kërkon të largohet nga batalioni.
- KAJOJA — Ç'është ajo që thua?! Luaj vendit! S'kam asi djemsh! (*Hamdiut.*) U lodhe kështu, mor bir, apo si?
- HAMDIU — As jam lodhur e as jam trembur, baba, por në atë batalion s'dua të qëndroj më. Jam gati të vete ku të më çojnë, veç aty jo.
- KAJOJA — Mos të ka rënë njeri më qafë e s'e duron dot më?
- HAMDIU — Më qafë jo, po për të duruar, s'duroj dot më!
- KAJOJA — E po kështu kot s'më mbushet mendja mua, jo.

MALIQI — Nuk është kot, jo. Është më e thellë puna, o Kajo.

KAJOJA — E po thuaje ç'është për të thënë, mor bir, që ta marrim vesh e ta pleqërojmë.

HAMDIU — Baba! Para tri javësh na sollën si komandant batalioni Dalanin, djalin e Rakip Çezmës. Unë këtë s'e honeps dot.

KAJOJA — (Vrëret.) Hëm... E mora vesh... Do me thënë...

HAMDIU — Ku vajtën dhe e gjetën atë lanet për në atë vend!

KAJOJA — Si ia vë emrin kësaj ti, o Maliq?!

MALIQI — (Hiqet sikur s'ka dëgjuar.) Për se e ke fjalën?

KAJOJA — (I nxehur.) Po ti hiqesh kështu sikur s'merr vesh, apo si? Për se po flasim këtu?! E paktë të duket ty?! S'gjetët njeri tjetër, që vutë në krye të batalionit të birin e atij të mallkuarit?! Ka të drejtë Hamdiu!

MALIQI — (I nxehur.) S'ka hiç të drejtë Hamdiu e ca më pak ti!

KAJOJA — Oj...

MALIQI — Kështu, o po si! Po pse ç'kujton ti, more, mos e vunë atë për inat të Gurrarjve?!

KAJOJA — Atë e dini ju, që e vutë, por që të bëjë i biri i Rakip Çezmës ç'të dojë me djemtë e mi, këtë s'e gëlltit dot unë, or jo!

MALIQI — (I nxehur ngrihet në këmbë.) Turp të kesh për fjalët që nxjerr nga goja!...

KAJOJA — (Brof edhe ai në këmbë i nxehur.) Dëgjo këtu, ti! Vëre gjuhën mirë në zap, se, për perëndi, u prishëm keq bashkë!...

MALIQI — Ti të lajthitësh e unë të vë gjuhën në zap-ë?! Jo, or, jo. Në më mbajte për mend, sajdishtë, jo, jo... (Matet të ikë po Hamdiu i prët rrugën.)

HAMDIU — Të mos rrëmbehemi nga fjalët, o xha Maliq. Le ta marrim më shtruar e ta zgjidhim këtë hall.

MALIQI — Ta zgjidhim, or, ta zgjidhim, por këto punë nuk zgjidhen kështu. (Kajos.) Je burrë me një barrë mend e në kësi punësh do matur dhjetë herë e prerë një herë e jo pri e lësho! Ashtu del! (Ulet.) Oj! Do bëka i biri i Rakip Çezmës ç'të dojë me djemtë e tu sikur të ishin berra këta e jo djem e partizanë! As qimen e flokut s'u prek dot, se pastaj atij ia presin kokën. (Kajoja ulet.) Vete e më dëgjon një të ri që më tepër i flet gjuha dhe inati, sesa mendja...

HAMDIU — Po jo, or xha Maliq!...

MALIQI — Po pse ç'kujton ti, mor Hamdi, mos e bënë atë komandant për inat të Gurrajve? Jo, or, jo! Ja të ta thotë Maliqi ty. Asnjë në qarkor s'i di marrëdhëniet e Gurrajve me ata të Çezmës. Po edhe sikur t'i dinin, për hir të Luftës sonë zor se gjenin një më të mirë se ai. Kështu është, de!

KAJOJA — E pse më flet kështu, o Maliq. Ti m'i di hallet. Djeg si prushi plaga...

MALIQI — Edhe unë kam plagën time që më djeg jo më pak se e jotja, po gjersa e dhamë fjalën, lipset edhe ta mbajmë, se jemi burra...

KAJOJA — Fjalën e dhamë për tjetër gjë e jo për t'i mbajtur mbi zverk e për ti bërë byrazerë...

MALIQI — Gjene e shkele, Kajan! S'po ta kërkon njeri këtë as ty, as mua, por, ama, komandantët dhe komisarët nga radhët tona do t'i nxjerrim. Sot i biri i Rakipit, nesër djemtë e tu, apo të mitë, Kështu, o posi!

KAJOJA — (I kapur ngushtë.) Hëm... (Hamdiut.) Po Hyseni ç'thotë?

HAMDIU — Lëre ç'thotë Hyseni, o baba!...

KAJOJA — (Prerë.) Unë po të pyes ç'thotë Hyseni dhe ti asaj m'iu përgjigj!

HAMDIU — Po ja, u hëngrëm keq me fjalë. Ai thotë që batalionin s'e komandon Dalani po Partia dhe se ne s'luftojmë për të po për popullin; se për kesi punësh ata që drejtojnë s'na marrin dorën as ty, as mua, po vënë në krye atë që duhet vënë dhe mirë bëjnë; se unë s'po veproja mirë dhe se sjellje të tilla s'i kanë hiç hije një partizani e plot nga këto.

KAJOJA — Kështu ë?! (Maliqit.) S'ka zgjidhje tjetër kjo punë?

MALIQI — Unë s'jam për atë zgjidhjen tjetër, sepse ajo farë zgjidhjeje do t'i hapë gojën botës. «E patë ç'pajtim gjaqesh bëri Kajo Gurraj?! — do të thonë, — Me të vajtur djali i Rakip Çezmës komandant batalioni, djemtë e Kajos jo vetëm s'i folën e s'iu bindën, po edhe krisën e ikën nga ai batalion?!» Të nderojnë ty këto fjalë?

KAJOJA — (*Hamdiut.*) Dëgjomë mua këtu, ti! Hysninë e desha sç ju dua edhe juve që ju kam gjallë, por, ama, ju dua me nder. Ashtu de! Dhe, që t'i vëmë kapak, Partia atë vuri komandant dhe ju atij do t'i bindeni e ta nderoni si komandant. Kaq kisha!

MALIQI — Dhe s'duhej më tepër. Kështu flet burri, de! Të lumtë, vëlla.

KAJOJA — (*Hamdiut.*) Tani, në ke mall për grua e për fëmijë e në ke leje nga komisari, rri sonte. Jo, jo, merr me vete dhe Ganinë dhe nisu!

HAMDIU — Lejë e mall kam, baba, po unë do nisem, se e lashë Hysenin tepër të mërzitur, Po rri gjersa të errët mirë.

KAJOJA — (*Maliqit.*) E po?...

MALIQI — (*Duke u ngritur.*) S'kemi ç'e zgjatim, jo! Punët e mira e të qëruara flasin vetë. (*Dalin të tre, Sipari.*)

SKENA III

Dhoma e Nazmijes. Në vatër ka zjarr. Pranë zjarrit, përballë njëri-tjetrit janë Selimi, partizan, me Nazmijen. Bisedojnë shtruar.

NAZMIJA — Ja kështu, të kegen motra! S'qenë mjaft ato që hoqa në derë të babës, po na edhe këtu, në derë të burrit, ca më të hidhura.

SELIMI — Mos e jep veten, Nazo! Mbahu! Luftë është, motër, dhe kjo luftë e sotme është më e ngatërruar. Në këtë luftë çdo hap, do menduar, që nesër të mos pendohesh. Ca më i matur kërkohet ky hap nga ti e nga unë se, duam s'duam, edhe ti, edhe unë jemi fëmijët e Pashos. Unë do të të flas hapur. Motër të kam ty, po xha Kajos i jap të drejtë. Duhej ta bënte këtë që bëri. Ti vetë the që ai s'të ka lëshuar kurrë nga goja. Apo jo? Kjo tregon që ai të ka dashur e të ka respektuar mbi dy nuset e tjera. Po ç'faj ka ai që vjen Pashoja yt dhe imi dhe i pështyn mu në çanak, i shtur të birin, i vë edhe njollë? Është burrë zakoni ai dhe nuk e honeps dot ikjen e Qerimit me Ballin.

NAZMIJA — Po me mua ç'pati?

SELIMI — Po ti, moj motër, je e bija e Pashos dhe e shoqja e Qerimit. Pak të duken këto?

Pastaj, ai zemrën s'ta çan dot që të ta shohë. Ku e di ai ç'mendon e ç'gatuan ti.

NAZMIJA — Po ta dijë, se më njeh...

SELIMI — Të njeh, po të njeh si nuse, si nikoqire, si e pritur dhe e dashur. Është detyra jote tani t'i tregosh atij dhe botës se cila je ti, nga anon ti, por ama, jo me fjalë, po me punë.

NAZMIJA — Atë po bëj dhe unë.

SELIMI — Dhe të vazhdosh ta bësh, të mos lodhesh e të mos trembesh. Ti e unë vërtet kemi prerë çdo lidhje shpirtërore me babanë tonë, ca më tepër me vathën ku është futur ai, por, për botën, ai është babai ynë dhe ne fëmijët e tij. Do punë që të bindet bota, motër!

NAZMIJA — Do vërtet...

SELIMI — Sa për të, ai sytë nxjerrtë, më keq se po i nxjerr, po ne, motër, të mbijamë mirë njëri-tjetrin.

NAZMIJA — Ashtu, të keqen motra, ashtu!

SELIMI — Sido që të vejë puna, Pashon mos e qas brenda!

NAZMIJA — Bah! Llaf është ai!

SELIMI — Kajos qëndroi pranë. Me zemër e me shpirt të jesh e tëra me të! Me llafe bote mos u merr! Kush të bie në qafë, tregoi vendin. Të fshehtën e Luftës e të Partisë mos e nxirr. Shpirtin lëre të të dalë, po fjalën jo. Mos u kurse për asgjë. Dhe bota një

ditë do ta njohë dhe çmojë më mirë Nazmijen. Hakun s'ta ha njeri!

NAZMIJA — Më rrofsh, o vëlla i mirë! Mi fashite dallgët dhe më dhe zemër! (*E përqafton të vëllanë.*)

SELIMI — E po, meqë bukë hëngrëm, për të çlodhur u çlodha, ç'kishim për t'ia thënë një-ri-tjetrit ia thamë, tani s'mbetet gjë tjetër veç të ngrihem e të iki, se ja, po afron edhe mëngjesi dhe drita s'duhet të më zërë në fshat. (*Ngrihet, merr armët.*)

NAZMIJA — Po sikur të rrije dhe sot. Të çmallemi dhe ca. Mos ki merak se të fsheh motra.

SELIMI — (*Duke i hedhur duart në qafë.*) Unë ërdha me punë. Shokët presin përgjigjen, motër, e unë, gjallë-vdekur, duhet t'ua çoj sot. Po ti mos m'u mërzit! Prapë do të shihemi e prapë do të bisedojmë.

NAZMIJA — Mirë, të keqen, si ta kesh punën...

SELIMI — Siç të thashë, ë! Dalim?

NAZMIJA — Dalim! (*Dalin të dy, skena errësohet dhe pas pak ndriçohet po aty. Hyn Nuriu me një krah dru. I lë ato në fund të dhomës dhe nja dy-tre copë i vë te zjarri. Në këtë kohë hyn Pasho Pisha pa u ndier.*)

PASHOJA — Hë, mor trim i gjyshit, ku e paske tët ëmë?

NURIU — (*I trembur dhe i mërzitur kthehet përballë tij.*) Nga hyre ti?

PASHOJA — Nga dera hyra, nga tjetër.

NURIU — Pse, hapur e paskam lënë?!

PASHOJA — Hapur...

NURIU — 'Bobo, unë i ziu!

PASHOJA — Ç'pate kështu? Pse u zverdhe.

NURIU — Si or ç'pata? Po do më shajë nëna. Ajo s'lë njeri të hyjë këtu.

PASHOJA — Njeri mund të mos lerë të hyjë këtu dhe mirë bën, por mua do më lerë e do të më presë, se më ka baba...

NURIU — As ty s'të fut brenda ajo, jo!

PASHOJA — Pse kështu? Mos ia ka ndaluar gjyshi Kajo?

NURIU — Atë s'e di unë, po ajo kështu më ka porositur.

PASHOJA — Si të ka porositur?

NURIU — Që të mos fut brenda asnjeri, as ty, as babanë, as...

PASHOJA — Mirë, mirë, pa e shohim atë punë. Kë është?

NURIU — Kush?

PASHOJA — Jot ëmë, Nazmija.

NURIU — Poshtë, në hashef.

PASHOJA — Shko thirre! Thuaji që kam ardhur unë.

NURIU — Jo more! Të vete t'i them që të më zhdëpë?!

PASHOJA — Ec, ec, se nuk të nget. Jam unë këtu.

NURIU — Nuk vete, jo. Kam frikë. Dil jashtë ti që të vete t'i them!

PASHOJA — Si the, more, si the?! Të dal jashtë?!

NURIU — E, mo, të dalësh. Ç'do ti në shtëpinë tonë?

PASHOJA — (*Ashpër.*) Hë, mistrec, mistrec! U bëre dhe ti të më tregosh derën, ë?! (*E kap për veshi.*) Edepsëz! Dhe unë vij t'ju bëj derman...

NURIU — (*I shpëton nga duart e ikën te dera.*) S'të thirri njeri të vije, jo...

PASHOJA — (*E kërcënon.*) Dëgjo, se po të zura, ta mora shpirtin! Qen e bir...

NURIU — Ç'ti bëj që s'është gjyshi Kajo në shtëpi, po ai ta rregullon samarin ty!...

PASHOJA — (*Turret.*) E po pritmë, o qen e bir qeni! (*Nazmija i del përpara.*)

NAZMIJA — Lerma djalin rehat, se s'të ka asnjë faj! (*Nuriut.*) Shko poshtë me fëmijët, ha bukë dhe rri atje. (*Nuriu ikën.*) Ç'pate me djalin?

PASHOJA — (*Duke u ulur.*) Ti e ke mësuar të flasë ashtu?

NAZMIJA — Ca unë, ca jeta... Pse?

PASHOJA — Bukur e paske mësuar, për besë! U bë dhe surrati i tij të më tregojë derën mua?

NAZMIJA — Unë i kam thënë dhe mirë bën. Ç'de-she që erdhe këtu?

PASHOJA — Ja, thashë të bëja një rrugë e dy punë. Edhe komunistët t'i shfarosim me këtë operacion, edhe ty të të shihja e të të bëja derman.

NAZMIJA — Prandaj qenke bërë-kaq trim, se ke

ardhur me gjermanin, pa vetë zor të ta mbante të shkelje në këto anë. Sa për mua, të kam rixha, të më lësh rehat në hallet e mia. I kam boll ato.

PASHOJA — S'flitet kështu me babanë, moj bijë, jo! Thuamë një herë «Mirë se erdhe, baba!», pastaj e shohim edhe atë punë. Nejse. Ja për ato halle të erdha, se të kam evlat e më dhimbsesh.

NAZMIJA — S'të thirri njeri, jo.

PASHOJA — Për kësi punësh njeriu me mend s'pret ta thërrasin, po e di vetë se ç'duhet bërë. Bëhu gati tani!

NAZMIJA — Për se e ke fjalën?

PASHOJA — Erdha të të marr...

NAZMIJA — Të më marrësh mua?! E ku ke ndër mend të më çosh?...

PASHOJA — Në shtëpinë tonë, ku tjetër?

NAZMIJA — Ajo shtëpi s'është më imja. Vendi dhe nderi im janë këtu, në këtë shtëpi.

PASHOJA — Lëri llafet e bëhu gati tani! S'të lë më unë këtu, sikur...

NAZMIJA — Edhe unë veç e vdekur dal nga kjo shtëpi. Të thashë, nderi im është këtu.

PASHOJA — Se ku është nderi yt, atë e di unë...

NAZMIJA — E di unë ca më mirë, se flitet për nderin tim.

PASHOJA — E po nderi yt është dhe imi...

NAZMIJA — Po turpet e tua ç'janë, mos janë nderet e mia?

PASHOJA — (*Ashpër.*) Mos më bëj shumë dërr-dërr-dërr! Dhe dëgjo këtu, gjersa je fëmija im, më takon mua të të diktoj e ti të bindesh dhe, mos e zgjat shumë, po bëhu gati. Ja kështu!

NAZMIJA — Që je im atë, e di mirë. Edhe që jam jot bijë, e di, por ti ç'kishe për të më diktuar, ma diktove dhe unë t'u binda! Më dhe nuse në këtë derë. Tani s'jam më vajzë, po grua tridhjetecavjeçare, gjysmë e ve, nënë fëmijësh dhe zonjë shtëpie, prandaj s'të bindem dot, se kam mendtë e mia, detyrat e mia.

PASHOJA — Domethënë?...

NAZMIJA — Unë s'lëviz që këtej. Do rrit fëmijët. Kështu ma do edhe zemra, edhe nderi.

PASHOJA — Po pse, moj, nder ma quan ti këtë të flakur mënjanë si qen që ka bërë yt vjehërr?

NAZMIJA — Nder edhe të madh shumë, bile, sepse me atë që i bëri ti edhe në rrugë të madhe të më kishe hedhur, ishte pak.

PASHOJA — (*Ironik*) Po, po. Mirë thua, se donte të mos e prishte me komunistët, Ua ka frikën qenve.

NAZMIJA — Ti e di mirë që Kajo Gurraj nuk e njeh frikën...

PASHOJA — Po turpin e njeh ai?

NAZMIJA — Ca më tepër se të tjerët dhe duke

më hequr mua mënjane. s'beri gjë tjetër
veçse ruajtji nderin e tij dhe timin.

PASHOJA — Lëri, moj, llafet ti, se këtë që bëri ai
s'e bën njeri me mend në kokë, jo. Kësaj

ti thonë: «Kam inatin e gomarit, i turrem
samarit!» Ç'faj pate ti, moj?

NAZMIJA — Unë isha jot bijë dhe gruaja e atij tje-
trit e ai s'mund të dijë nga anoj unë.

PASHOJA — Dhe, demek, kështu do ta mësuaka?!

NAZMIJA — Doemos që do ta mësojë. Do t'ia
tregoj unë, në mos sot, nesër.

PASHOJA — (*Që e keqkupton.*) E po kështu më
fol mua de! Hë, më rrofsh e më bëfsh hair!

Tregoja Kajo Gurrajt se e kujt bijë je!

NAZMIJA — Se e kujt jam, nuk do t'ia tregoj, se
dihet dhe e njeh bota, por se cila jam unë
këtë e kam treguar dhe do ta tregoj para
gjithë botës.

PASHOJA — E si më njohka bota mua, pa më
thuj?

NAZMIJA — Pyete të ta tregojë.

PASHOJA — E kam pyetur e më ka nderuar, se-
pse jam i lidhur me parinë e vendit.

NAZMIJA — Dhe me Tahir benë, që të telendisi në
mes të fshatit! Edhe...

PASHOJA — (*Ashpër*) Mbylle!

NAZMIJA — Edhe sot më ngjethet mishtë, kur e
kujtoj...

PASHOJA — Mbylle po të them!

NAZMIJA — Nuk e mbyll. jo! Bëre be e rrufe

se do ta laje turpin me gjak, por, ama, porsa të erdhi Isuf beu e të fërkoj krahët, e harrrove të rrahurit e Tahir beut. Jo vetëm kaq, por që atë ditë u bërë mik me ta dhe e hapte derën dykanatëshe për të pritur e për-cjellë bejlerë dhe italianë. S'dëgjove asnjë nga ne: as gruan, as fëmijët, as vëllazërinë, po u bërë njësh me ta, gjersa përfundove ballist.

PASHOJA — (*Brof në këmbë.*) S'je bërë ti, moj e paudhë, të më tregosh mua turpin dhe nderin, jo! (*Matet ta qëllojë.*)

NAZMIJA — Prapsu! Po që e shite edhe atë pak mall e gjë që pate, për të gostitur bejlerët dhe italianët, duke e lënë tët bir me gisht në gojë e trokë, ç'do të thuash?

PASHOJA — Moj, po do ta mbyllësh ti, apo si e ke hallin?! (*Matet t'i afrohet.*)

NAZMIJA — Prapsu, po të them! Po që i hëngre shpirtin sime ëme, gjersa e vdiqe, ç'do të thuash?

PASHOJA — (*I papërmbajtur.*) Edhe këtë ma the, moj e çmendur?! Po ti e di, moj harramsëze, që jot ëmë vdiq nga veremi. Unë hyzmetin ia bëra sa askush tjetër nëpër doktorë e spitale. Harxhova qimet e kokës për të. E di ti këtë?!

NAZMIJA — E di, posi. E di që pasi e bërë verem, e plase në një spital, sa për t'i treguar botës se ja cili është Pasho Pisha, e

s'çavë! kokën për të. Vetë, po, doemos, kuplarave, kafeneve e ziafeteve sa më bejlerë, aq edhe me italianët. Harrove se ku të gjetën kur ajo po hiqte shpirt?!

PASHOJA — (*I afrohet kërcënueshëm.*) Mbylle, moj, gojën, se, për perëndi, të mora shpirtin!

NAZMIJA — (*E vendosur.*) Nuk e mbyll, jo, dhe ti ç'të dish, bëj! Një jetë të tërë të kemi duruar im më, unë dhe im vëlla. Jemi gjer këtu me ty. (*Vë dorën mbi kokë.*) Dhe tani kërkoke të më marrësh me vete, pale!...

PASHOJA — (*I thyer.*) Po, për të mirën tënde, erdha, moj, e çmendur...

NAZMIJA — Të mirën time dhe të fëmijëve të mi do ta gatuj vetë! S'dua të më përzihet njeri.

PASHOJA — Bëj si të duash! Sytë nxjerrç! Po, ama, në mbetsh keq, mos më thuash «Aman, baba!».

NAZMIJA — Kurrë! (*Pashoja niset të dalë.*) Edhe një fjalë të kam.

PASHOJA — (*Ndalet pa u kthyer.*) Pa hë!

NAZMIJA — Këtë që bëre sonte, mos e përsërit më! Më lër rehat në hallet e mia!

PASHOJA — Edhe këtë ta paska kërkuar Kajo Gurraj?!

NAZMIJA — Kajo Gurraj s'ka kërkuar asgjë. Këtë po ta kërkoi unë...

PASHOJA — Mirë, mirë, pa do të shihemi prapë.
(*Niset.*)

NAZMIJA — A, jo! Ne skemi për t'u parë më.
Kjo luftë na dha rrugë të ndryshme, që s'piqen kurrë në një shteg.

PASHOJA — (Kthehet përballë.) S'i dihet. Është e ngatërruar kjo luftë e gjaku ujë s'bëhet, jo.

NAZMIJA — Unë kaq di të të them. Kjo luftë na mësoi shumë gjëra, por të parën na mësoi këtë.

PASHOJA — (*Shpërthen.*) Po, doemos, komunistët atë duan, të shturet familja, djali dhe vajza të ngrihen kundër t'et, vëllai kundër vëllait, shashërdi hesapi, të mos e marrë vesh dreqi të birë... Ja, këto më bënë ballist dhe ja ku po ta them që pa bërë batërdinë mbi komunistët, s'iki nga kjo dynja, jo. S'do ta kursej as tim bir, gjersa të shfaroset kjo farë e hidhur që molepsi këtë tokë dhe njerëzit e saj.

NAZMIJA — Ruaj lëkurën tënde, Pasho Pisha pa komunistëve u merr të keqen ti.

PASHOJA — (*Tërhiqet.*) E shoh që je ndërkyer, prandaj më mirë po iki sesa të bëhem turp i botës. (*Ikën.*)

NAZMIJA — Bëre mirë që ike, o i mjerë! (*Sipari.*)

A K T I II

SKENA IV

Po dhoma e skenës së parë. Në vatër ka zjarr. Sabikoja, Neta dhe Bulja duke thurur triko e çorape. Jashtë bie borë e fryn erë.

SABIKOJA — *(Bules)*. Nuse, vëri edhe nja dy dru zjarrit. Sonte s'ndiej të ngrohur gjëkundi.
(Bulja shkon e merr dru.)

NETA — Janar i ftohtë si ky i sivjetmi, s'është parë ka kaq vite.

SABIKOJA — Lëre, lëre! Kiameti i të ftohtit po bën. Ne brenda dhe s'ndiejmë të ngrohur gjëkundi, po djemtë, djemtë e nënës si e kanë hallin në këtë të ftohtë e në këtë luftë?!
(Bulja sjell dru, ia vë zjarrit dhe ulet.)

Apo s'janë edhe të pangrënë e të zhveshur...

BULJA — Janë të rinj ata, nëno.

SABIKOJA — Të rinj janë, moj bijë, të rinj, po s'pyet as të ftohtit, as plumbi për të ri e për plak, jo. Thuaj që i ruan perëndia, pa... (Ndihen të lehurat e qenit dhe trokitje të lehta.) Ç'ka ky i uruar që leh?

NETA — Dikush troket në portë, më duket...

SABIKOJA — Mos të bëjnë veshët?

BULJA — Jo, jo... Trokasin. (Ngrihet.)

SABIKOJA — (Ngrihet dhe ajo.) S'keni punë jashtë, ju! (Ngjesh revolen në brez e del në paraskenën oborr.) Kush troket?

ZENELI — Hape, hape! Jam unë, Zeneli.

SABIKOJA — Cili Zenel, more?

ZENELI — Zeneli i Lytos.

SABIKOJA — Vetëm je?

ZENELI — Vetëm, vetëm, po hape!

SABIKOJA — (Hap portën, futet Zeneli dhe e mbyll, përsëri.) Ç'ka bërë vaki, more bir, që më del në këtë të ftohtë?

ZENELI — Më dërgoi babai...

SABIKOJA — Mos m'u ka ndodhur gjë djemve?

ZENELI — Jo, moj hallo, jo, po babai më dërgoi t'ju them se fshati është mbushur prapë plot gjermanë e ballistë. Janë bërë si të tërbuar. Kanë filluar të kontrollojnë shtëpi me shtëpi, dogjën shtëpinë e Koçinjve.

SABIKOJA — U djegshin lugetër, u djegshin! Ç'kanë me popullin fukara?!

ZENELI — Çkanë de? Babai më tha që po që ndonjë nga djemtë, të iki sa më parë. Të marrë nga rruga e çukave, të lërë luadhet mënjane e drejt e në pyllin e Lajthive. Atje do të gjejë dhe shokët.

SABIKOJA — Më rrofsh, mor bir, po i thuaj Lytos që s'kam asnjë nga djemtë këtu. Edhe Kajoja s'di se ku ka ikur me Maliqin.

ZENELI — Për xha Kajon e dinte ai, po kishte merakun e djemve...

SABIKOJA — Më rroftë e ia shpërblefsha për të mira. Po ti, mor të keqen halla, si do të shkosh në shtëpi në mes të gjermanëve? Ruaju, të keqen, së janë të prapë ata!

ZENELI — Do t'ia mbath për te pylli i Lajthive edhe unë. Atje më pret edhe babai.

SABIKOJA — E po ik, të keqen halla, se mos bëhesh vonë dhe hap sytë, ruaju! (*Hap portën, Zeneli ikën dhe ajo kthehet në dhomë.*)

NETA — Kush ishte?

SABIKOJA — Zeneli i Lytos. E kishte dërguar i ati të na lajmëronte se fshati është mbushur plot gjermanë e ballistë. Kishte frikë mos kishim ndonjë nga djemtë këtu e të largohej sa më parë, se po bëjnë kontroll shtëpi më shtëpi.

BULJA — (*E trembur.*) Kontroll, the?

SABIKOJA — E, kontroll. Po ti ç'pate, pse u zverdh dhe? Mbaje veten! Jam unë këtu! Le që s'ka-

- në ç'na bëjnë, jo. (*Ndihen krisma armësh që bien në trup. Ato heshtin e përgjojnë.*)
S'm'u dukën hiç të mira këto krisma në këtë orë!
- NETA — Mos u shqetëso, nëno, se shtien nga frika ballistët e gjermanët.
- SABIKOJA — Jo, moj bijë, jo. Ranë në trup, të shkretat.
- BULJA — Edhe mua, ashtu m'u dukën... Ku vajti na iku dhe babai sontë...
- NETA — Duhej të ikte. Ishin keq partizanët, Bule, dhe atë erdhi e mori xhà Maliqi... Po ti mos ki frikë. S'kanë ç'na bëjnë ne, Jemi gra.
- BULJA — Se mos pyet gjermani për gra e për burra. Të vë zjarrë e të shkon në plumb.
- SABIKOJA — E mjaft, de! Edhe ne s'jemi pa njeri, jo! Tërë vëllazërinë pranë e kemi. S'do ta lënë gjermanin të bëjë ç'të dojë me ne.
- NETA — Pastaj këtej sillen dhe krushku Pasho me Qerimin. Do ta bëjnë dhe ata të tyren. (*Ndërkaq Neta ka vajtur në dritare e diç përgjon jashtë.*)
- SABIKOJA — Ata mos i zërë në gojë, se edhe atë të marrë vesh yt vjehërr, dhe ia vuri vetë zjarrin shtëpisë. Dhe, dëgjoni këtu, erdhi krushku a Qerimi, asnjë nga ju të mos du-

ket, se pastaj të gjejmë vrimë e të futemi nga ai.

NETA — (Nga dritarja duke përgjuar.) Ca hije ka-luan pranë oborrit, u ndalën pranë gardhit, diç lanë aty e u zhdukën. (Ndihet e lehura e qenit.)

SABIKOJA — Si the, moj?!.

NETA — (Gjithë aty.) Diç lanë aty pranë gardhit...

SABIKOJA — T'u thaftë gjuha, nuse!

NETA — Shë..ë..ët! Sikur rënkon dikush, (Të gjithë heshtin e përgjojnë.)

BULJA — Ë-hë! Edhe unë dëgjoj një rënkim të mbytur.

NETA — Të dalim, nëno!

SABIKOJA — E zeza unë, djemtë! S'më bëjnë këmbët. M'u prenë gjunjët.

NETA — Rri ti, se dalim ne.

SABIKOJA — Jo. Pritni! (Netës) Ti, bijë, merr dyfekun! Di ta zbrazësh?

NETA — Di.

SABIKOJA — Ashtu de! (Bules.) Ti tjetra merr ç'të mundësh: sëpatë a hanxhar, a... veç pa zhurmë. Do të dal unë e para (Dalim në paraskenë që përfaqëson oborrin e rrethuar me gardh.) (Qenit) «Hesht, Balo!» Kush është? A ka njeri? (Ndihet një rënkim i mekur) Kush je ti, more? (Heshtje e ajo Netës.) Mbaje gishtin e po lëvizi njeri, shkrepja.

(Ndihet rënkim.) Fol, mor, kush je ti se të vramë!

ZËRI — (I dobët) Par...ti...zan!

NETA-BULJA — Partizan, nëno Ta ndihmojmë!

SABIKOJA — Pritni! (Zërit) Në je vërtet partizan, ngrehu të të shohim.

ZËRI — (Bën përpjekje, por s'leviz dot. Rënkon.) S'ngrihem dot! (I këputet zëri.)

SABIKOJA — (Duke iu afruar zërit u bën shenjë nuseve të afrohen.) Hë, bija, ta ndihmojmë. (Zërit) Kush të katandisi kështu, more bir?

ZËRI — Njerëzit e Pasho Pishës, o nënë. Kujtuan se më vranë e më tërhoqën zvarrë deri këtu e ikën e më lanë.

SABIKOJA — Iu thaftë dora atyre që të katandisën kështu! (Nuseve) Hë, ç'prisni?! Kapeni ta futim brenda!

ZËRI — (Sapo nisnin ta kapin, ai me zë të këputur.) Jo. Mos më futni brenda! (Nuset prapsen me dyshim, i plagosuri dikujt i shembëllen.)

SABIKOJA — U?! Ç'është kjo, more bir? Ti je bërë për ibret. Pastaj në këtë të ftohtë e me këto plagë, s'i dilet. (Nuseve) Kapeni!

ZËRI — Mos më fut brenda!

SABIKOJA — Po pse, more bir?

ZËRI — Sepse do të kesh telashe me mua.

SABIKOJA — Telashe, pa telashe, ne s'të lëmë dot jashtë.

ZËRI — (*Insiston.*) Jo nënë, jo, Ti s'më njeh kush jam.

SABIKOJA — Të njoh, s'të njoh, mos e zgjat tani. Si ty unë kam djemtë, mor bir. (*Nuseve.*) Kapeni! (*E kapin.*)

ZËRI — M...o...s (*I bie të fikët.*)

NETA — I ra të fikët.

SABIKOJA — Lëvizni shpejt, sa është kështu, ta futin brenda. (*E kapin të tria, e futin brenda dhe e shtrijnë pranë zjarrit.*) Hë, lëvizni! Legenin me ujë të ngrohtë, grisni ndonjë çarçaf sillni duhan e raki! (*Nuset largohen e ajo i fshin ballin e djersitur.*) Biri i nënës, trimi i nënës, partizani i nënës! Mbahu, të keqen, se do të kalojë, do të kalojë, të keqen nëna! (*I fshin djersën.*) Mjerë nënë zeza, o bir, që s'di në ç'gjendje të kanë katandisur maskarenjtë. Edhe unë nënë jam, nënë partizanësh. Edhe atyre ndoshta ua fshin djersët ndonjë motra ime me dhembshuri nëne. (*Hyjnë nuset dhe sjellin gjithçka duhet dhe të tria fillojnë nga pastrimi dhe mjekimi i të plagosurit, që, herë pas here nxjerr rënkime, të cilave Sabikoja u përgjigjet.*) «Duro, të keqen nëna, duro! Do bëhesh mirë, të keqen! (*Paşi e mjekojnë, e fashojnë me rripa çarçafi.*) Po tani ku ta vendosim, moj bijë?

NETA — Unë them lart, në musandrën e dyshekëve.

BULJA — Po ajo është plot...

SABIKOJA — E zbrazim. Atje do ta çojmë, veç dëgjoni këtu. Asnjë s'duhet ta dijë këtë që ndodhi sonte! Dëgjuat?! Tani, kapeni ta çojmë atje ku thamë! (*Të tria e kapin dhe e çojnë matanë. Pas pak kthehet Sabikoja me Netën.*)

SABIKOJA — (*Duke hyrë.*) Hap sytë, nuse, mos të shpëton gjë e ia thua Nazmijes. S'dimë akoma ç'bluan ajo. Ti e dëgjove ç'tha partizani: «Njerëzit e Pashos e kishin katandisur për ibret!»

NETA — U. pse llaf për t'u thënë është ky, moj nëno! Mos ki merak.

SABIKOJA — (*Ulët*) Le pa... s'dimë ç'do të thotë edhe ai jetëgjati kur ta marrë vesh?!

NETA — «Mirë keni bërë» do të na thotë, se edhe ai vetë po të kishte qenë, këtë që bëmë ne do të bënte.

SABIKOJA — E, moj bijë, e, po është burrë ai dhe zot shtëpie, kurse ne jemi gra. Rroimë nën hijen e tyre. (*Hyn Bulja.*) Hë, si duket?

BULJA — S'përmendet fare, i ziu.

SABIKOJA — Le të flejë, le të flejë! Gumi mirë i bën. Ulu!

BULJA — (*Duke u ulur.*) Më duket se Nazmija diçka ka nùhatur...

SABIKOJA — Hap sytë mos i the gjë ti, se pas-taj...

BULJA — Jo, për kokën e fëmijëve! Ç'ne unë...
SABIKOJA — Epo si? Ç'të tha?

BULJA — Më pyeti «Ç'qe ajo e dala juaj qëpa-
rë në oborr?»

SABIKOJA — Po, ti, ç'i the?

BULJA — I thashë që erdhi një shok i djemve
dhe nëna e futi brenda.

SABIKOJA — Mirë i paske thënë. Ku të vajti
mendja!

BULJA — Ç'të bëja, u zura ngushtë.

NETA — Po ajo ç'të tha?

BULJA — Vuri buzën në gaz e më tha: «Ç'tha
për djemtë, mirë janë».

SABIKOJA — Hë, e bija e gjarprit! Në filloftë t'i
nxjerrë këmbët edhe kjo si i ati, mos më
thëncin Sabiko, po nuk ia preva që në rrë-
zë. Le që po e mori vesh i vjehrrri, e sikte-
risi nga shtëpia!

BULJA — Edhe unë s'para i zë besë asaj. (*Ka
hyrë Nazmija pa u ndier dhe pa u vënë re.*)

NAZMIJA — Kujt nuk i zë besë ti, Bule, mua?

SABIKOJA — Po ti, ç'ne këtu?!

NAZMIJA — Duhej të vija, prandaj erdha.

SABIKOJA — S'ke punë ti këtej, jo! Të ka thënë
yt vjehërr.

NAZMIJA — Epo kusuret e tim shoqi s'ka pse t'i
heq vetëm unë. Djalë e kishe ti, po ty s'të
thanë asnjë fjalë, e s'të vunë asnjë faj, kur-
se mua...

SABIKOJA — I kam edhe tre të tjerë malit unë,
pastaj yt atë e futi në atë rrugë dhe ti, po,
doemos, ortak me ta....

NAZMIJA — Mos më bini kot më qafë! Në kë-
të histori jam aq ortak sa ç'jeni dhe ju.

SABIKOJA — E po ka një krye shtëpia dhe kush
e shkel fjalën e tij, s'ha bukë me të.

NAZMIJA — Veçse nuk qesh unë që ia shkela
fjalën, por i biri, (*Sabikos*) ai bir që ke më-
kuar ti me gjirin tënd.

SABIKOJA — Unë e kam bërë lanet! Haram sisën!

NAZMIJA — Po kur e bëka lanet nëna të birë,
pse të mos e bëjë gruaja të shoqin, që i la,
turpin dhe barrën mbi supë?

SABIKOJA — Më gjatë s'di unë. Këto thuaja tët
vjehri. Ai vendos këtu.

NAZMIJA — E di dhe ashtu do të bëj. (*Bulja dhe
Neta i afrohen.*)

NETA — Thuaja, Nazmije, thuaja se, kushedi zbu-
tet!

BULJA — Mirë thotë.

NAZMIJA — Po, motra, do t'ia them (*Sabikos*) dhe
tani dëgjomëni dy fjalë: s'erdha këtu as për
t'ju përgjuar, as për t'ju thënë ato që ju
thashë, po për të rrahur e vendosur për atë
që ndodhi këtu. (*Sabikoja do ta ndërpresë,
por ajo vazhdon.*) Unë i di të gjitha, nëno!

SABIKOJA — Ç'di ti, moj?!

NAZMIJA — Edhe ato që s'i dini ju. Tani t'i gjejmë derman kësaj pune sa pa ardhur babaja Kajoja.

SABIKOJA — Fol, moj, ç'di ti, se më çmende?!

NAZMIJA — A e di zotrote kë ke futur brenda sonte?...

SABIKOJA — Partizan kam, futur, bir nëne kam futur, atë që e katandisi për ibret yt atë me larot e tij kam futur, po ti të mbyllësh gojën, se po doli fjala, u bë e madhja.

NAZMIJA — Ju mendoni ç'të doni, por të plagosurin që futët brenda sonte, duhet ta sillni tek unë, sa pa ardhur babai...,

SABIKOJA — Bah?! Je në vete?! Kurrë!

NAZMIJA — Po ti s'e di kë ke futur brenda, moj nëno.

SABIKOJA — Të thashë njëherë që partizan, e bir nëne kam futur, kushdo qoftë ai.

NAZMIJA — Po ai është...

NETA — (Që e nuhat.) Mos, Nazmije, në ke besuar perëndi!

SABIKOJA — (E nxitur.) Fol, kush është ai?! (Neta zë veshët, Bulja hiqet mënjanë.)

NAZMIJA — Është djali i emërharruarit që të shkretoi Hysninë!

SABIKOJA — (Tepër e tronditur) Mos! T'u thaftë gjuha, nuse! Ç'pate që ma the!

NAZMIJA — Do ta merrje vesh, në mos tani, më vonë.

SABIKOJA — (*Fillon kujën.*) Bir, bir, bir, o Hysniu i nënës! Fale nënën, bir, që me duart e saj futi brenda e mjekoi plagët e djalit të atij, që të shkretoi ty, o bir! (*Nuset i afrohen, e qetësojnë, e ajo pasi e mbledh veten i thotë Nazmijes.*) Po ti, moj, nga e di që është ai?

NAZMIJA — Ndajnate më erdhi një ballist. E kishte dërguar im atë...

NETA — Dhe ti e fute brenda?

NAZMIJA — Jo, As në oborr s'e lashë të hynte, por ai ç'pati për të më thënë, m'i tha....

SABIKOJA — Ç'të tha, moj emërharruar?!

NAZMIJA — «Pashoja dhe Qerimi i çojnë të fala babait që t'u pijë shëndetin, se sonte e laj-në gjakun e Hysniut. Kurbanin do t'ia sjellin në oborr që ta shohë me sytë e tij e të ngopet.»

NETA — Dhe ti heshte e u bëre ortak me ta? Turp të kesh!

NAZMIJA — Jo, motër, unë s'heshta dhe ç'munda të bëja, e bëra. Babai s'ishte këtu, që t'ia thosha, prandaj u detyrova dhe dërgova tim bir, Nuriun, në shtëpinë e Rakip Çezmës që ta lajmëronte nga ana e babait se ballistët kishin vënë njerëz në pusi që të vritnin cilindo mashkull që do të dilte nga ajo shtëpi.

NETA — Po Nuriu kujt ia tha këto fjalë?

NAZMIJA — Vetë Bexhetit, që kenë matanë.

NETA — Po ai ç'i kishte thënë?

NAZMIJA — E kishte puthur dhe i kishte thënë: «Bëji shumë të fala gjyshit nga unë dhe i fale nderit. Të mos ketë merak se do të ruhem». Po, siç e patë, s'u ruajt dot.

SABIKOJA — Tani u bë lëmsh fare puna! Ec e gjeja fillin!

NAZMIJA — Ja pse them ta sillni tek unë, sa pa ardhur baba Kajoja. Le të bjerë edhe ky faj mbi mua, mjaft që të shpëtojë ai dhe ju bashkë. Pasi ta marrë vesh baba Kajoja, bëni si të doni.

SABIKOJA — Po sikur ti...

NAZMIJA — Mos, nëno! Mos më ngarko më shumë, se jam njeri dhe unë! Kam edhe unë nderin tim. Fshati është plot me gjermanë e ballistë e kushedi ç'u shkrep në kokë të bëjnë. Tek unë s'kanë si dyshojnë, po edhe në dyshofshin, para Pashos dhe Qerimit dal vetë.

SABIKOJA — (E hutuar.) Po ju ç'thoni, moj nuse?

BULJA — Si të urdhërosh zotrote.

NETA — Unë them ta çojmë te Nazmija.

SABIKOJA — Po sikur kjo...

NETA — Jo, nëno. Nuk e bënë kurrë Nazmija këtë! Ja, kokën time!

SABIKOJA — (Nazmijes.) Mjerë ti, o e zezë, po e gjeti gjë atë! (Nuseve.) Ashtu le të bëhet. Çojeni atje!

NETA — Po eja edhe ti, nëno!

SABIKOJA — Unë s'e zë më me dorë atë! Merreni dhe hiqmani! (Nuset dalin, errësim i plotë dhe pas pak ndriçohet. Po ajo skenë. Kajoja pranë zjarrit pi duhan i mërztitur dhe tund kokën. Diçka e mundon.)

KAJOJA — (Monolog.) Si vajtën këto punë kështu?! Bën hasha evlatin tënd dhe strehon e mbron të birin e atij që të ka përvëluar xhanë! Hë, të kam rixha, jepi dum kësaj. (Neta sjell një kërcu e ia vë zjarrit.) Si është?

NETA — Rëndë, baba. Shumë rëndë...

KAJOJA — Pisk e kemi punën me të, pisk...

NETA — Po, ama, Nazmija po ia mban shpirtin me zor...

KAJOJA — Me zor, me zor t'ia mbajmë, se po na e gjeti gjë këtu, vajti nderi i Kajos!

NETA — Pa e ngritur më këmbë atë s'ka derman ajo, jo.

KAJOJA — A thua?

NETA — Mbrëmë, kur e çuam tek ajo, na tha mua dhe Bules: «Atë që prishën njerëzit e tim eti e im shoq, më takon mua ta ndreq dhe unë do ta ndreq!»

KAJOJA — Hëm... E zonja është, e mirë është, trimëreshë është, po ç'e do, sikur të mos

mjaftonte vetëm Pashoja, na hyri edhe Qerimi në atë valle... Ç'ti thosha sot kur erdhi e më foli gjerë e gjatë? Fjalët me mend i tha, apo ec e ma mbush mendjen mua se.

NETA — Zotrote i di më mirë këto punë...

KAJOJA — E po ja që nganjëherë s'i di as unë, se janë bërë lëmsh e s'ua gjej dot fillin. (*Hyn Sabikojë.*) Të kam thënë kaq herë, moj e uruar, që ta vësh gjuhën në zap e fjalët t'i lëshosh me kandar! Ashtu de! I ke rënë si shumë më qafë nuses së madhe...

SABIKOJA — Sepse m'i nxore ti edhe ato pak mend që kisha! S'di as unë si të sillem me të. (*Hutohet.*) Pa dale, pse erdha?! (*Kujtohet*) Hë. Maliqi. Po vjen Maliqi!

KAJOJA — Maliqi, the?! (*Duke u ngritur.*) Sikur shumë lëviz edhe ky i uruar! Fshati plot me gjermanë e ballstë e ai vëc këtej e vëc andej. (*Netës*) Ik, bijë, ik, se Maliqin do ta ketë nxjerrë halli për këtu. (*Sabikos.*) Edhe ti shiko punët e tua. (*Sabikojë e Neta dalin e Maliqi hyn.*) Po ti ç'më lëviz kështu?! Ke qejf të të mbërthejnë apo të të këputin ndonjë plumb gjermanët e ballistët?! (*Maliqi ulet.*)

MALIQI — Epë dikush duhet të merret me këto punë de. Ja që shorti më ra mua e unë bisht s'u bëj dot.

KAJOJA — Bisht jo, por me karar.

MALIQUI — Po ja që punët s'pyesin as për lodhje e pleqëri, e as për gjermanë e ballistë bashkë. Po na bëjnë zullume të mëdha me këtë operacion. Po na djegin fshatrat e po na vrasin njerëzit, Kajo vëllai...

KAJOJA — Po ne, ç'presim?! Të mbledhim njësitin e t'u biem...

MALIQUI — Do t'u biem, do t'u biem, po çdo gjë me urdhër. Hë për hë na kërkohet që të dalim nga ky operacion me sa më pak humbje. Këtë do të bëjmë edhe ne. Kur të vijë koha, do t'ua nderim, që të mos dinë nga të venë. (Pauzë) Dhe tani, të dalim në shteg. Si është?

KAJOJA — (I kapur në befasi.) Kush?

MALIQUI — Ore si është, po të pyes? Gjallë?

KAJOJA — Kush po të pyes edhe unë?

MALIQUI — Bexheti, djali i Rakip Çezmës, kush tjetër?

KAJOJA — Edhe këtë e ditke?

MALIQUI — Po, doemos. Ma do puna. Edhe që e plagosën njerëzit e Pasho Pishës e di; edhe që ta dërgoi në oborr e di; dhe që e futi brenda jot shoqe me nuset, e di; edhe që yt nip, Nuriu, vajti dhe e lajmëroi Bexhetin që Pashoja kishte vënë njerëz për ta vrrarë e di...

KAJOJA — (E ndërpret.) E po ç'i thua kësaj ti, o Maliq?!

MALIQUI — I lumtë, për besë! Ka bërë bujë në fshat dhe të gjithë ju mbajnë në gojë për të mirë...

KAJOJA — Dhe e bëri me kokën e saj, burrëresha...

MALIQUI — Po, doemos. Ti, mos ma merr për keq, s'do ta kishe bërë dot, Kajo.

KAJOJA — Zor do ta kisha vërtet. (Pauzë.) E po?...

MALIQUI — Diç do bërë, doemos. Ajo, or byrazer, çdo ditë po e tregon veten se është me ne dhe, duke qenë jona, do ta ketë edhe zemrën të gjerë e do na falë. Megjithatë, ti bëj si të të mbushet. Tani, pa më thuaj si është Bexheti?

KAJOJA — (Me ngasje.) E ç'të të them? Ti edhe këtë e di. Apo ta ka qejfi ta dëgjosh nga unë?

MALIQUI — E ja, këtë s'e di. Prandaj edhe erdhja.

KAJOJA — Rëndë, shumë rëndë është, o Maliqu. Ka disa plagë...

MALIQUI — Hë. Po ku e ke vendosur?

KAJOJA — Tek ajo, te Nazmija.

MALIQUI — Si?!

KAJOJA — E, or, tek ajo e kam. Vetë ka ngulur këmbë ta marrë dhe mua më duket se mirë ka bërë.

MALIQUI — (Kruan kokën i mëriztur.) Hëm...

S'di ç'të them. U zura ngushtë e tani s'i
jap dot dum.

KAJOJA — Meqë gjermanët e ballistët i ke në
fshat, më të sigurt se atje s'ke ku e çon.

MALIQI — Edhe kjo mendje e saj, apo jo?

KAJOJA — E tëra e saj dhe jo vetëm mendja, po
edhe zemra. Mbi kokën e tij po ngryset e
po gdihet.

MALIQI — Gjë e madhe, Kajan, veç ty, të kam
rixha, sido që të venë punët, të jesh gjak-
ftohtë dhe i matur. Këto punë s'duan ve-
tëm trimëri, por ca më shumë duan urtë-
si. Ashtu de!

KAJOJA — Mos e ki atë frikë, veç dua të ma
shkoqitësh, ç'deshi djali i Rakip Çezmës në
shtëpi në këtë operacion, ë? Se është edhe
partizan, de?!

MALIQI — Mos e ushqe atë mendim të keq, o Ka-
jo. Dëgjo Maliqin ti.

KAJOJA — Të pyeta e po pres përgjigjen, Maliq.

MALIQI — S'ka të bëjë ardhja e tij as me ty, as
me mua. Kështu e urdhëruan kështu bëri.
Punë lufte këto, Kajo.

KAJOJA — (*I penduar.*) Ma bëj hallall, o Maliq.

MALIQI — E po mirë atëherë, meqë u qetësove,
tani, hë, o burra, më ç'o te Bexheti. Dua ta
takoj vetë atë, jo se s'të besoj ty, por sepse
duam të lidhemi me të për ca punë të Luf-
tës.

KAJOJA — (*Duke u ngritur.*) Të çoj unë, o po si,
ja, që këtë çast. (*Ngrihen dalin të dy Sipari.*)

SKENA V

Ndriçohet paraskena, që përfaqëson oborrin e shtëpisë. Kajoja dikë pret në këmbë duke thithur duhanin. Nga ana tjetër hyn Nazmija.

NAZMIJA — Më deshe gjë, baba?

KAJOJA — E, të desha, të desha. (*Pauzë.*) Ti e more vesh që sat vjehrrë i vdiq i vëllai...

NAZMIJA — Lëre, lëre!...

KAJOJA — Ashtu de. Puna është që do të nise-mi që tani për në Bletas. Mirë po...

NAZMIJA — Doemos duhet të niseni.

KAJOJA — Mos ma pri fjalën! Ashtu de! Mirë po mua më ha merakun për ato që më the dje. A thua të vijë sonte Pashoja për të kërkuar Bexhetin?

NAZMIJA — S'ma ha mendja, baba....

KAJOJA — Ej! Pse kështu?

NAZMIJA — Sepse Pashon vërtet e ha merakun që

Bexhetin e ke fshehur zotrote, por ai, ama prapë e heq veten si mik të kësaj shtëpie, prandaj pa kontrolluar gjithë fshatin, që të sigurohet mirë e mirë, zor se niset për këtu...

KAJOJA — A thua?!

NAZMIJA — Në qoftë se i kanë mbetur dy para mend, kështu duhet të bëjë...

KAJOJA — Po sikur t'i kenë roitur, ç'bëhet?

NAZMIJA — Atëherë mirë se të vijë. Do ta pres vetë.

KAJOJA — E ball dot, thua?

NAZMIJA — As që më bën tërt syri! Mos e ki hiç atë merak, baba!

KAJOJA — Po dhembjen (*I bie gjoksit me grusht.*), po turpin, t'i ha me bukë thua? Ç'do të thonë bota? Iku Kajo Gurraj dhe la një shtëpi të tërë me gra e me fëmijë t'i bënëin ballë gjermanit dhe Ballit bashkë.

NAZMIJA — Bota vërtet ka gojë, baba, po ka dhe mend. Ajo e di që Kajo Gurraj s'iku as nga frika, as nga qejfi, po nga halli. Iku se duhej të ikte, se e kërkonte nderi dhe vendi. Sa për gjermanin të jesh i qetë, nuk e sjell Pashoja me vete, se ia di huqet e s'e ndal dot.

KAJOJA — E, moj bijë, e, po jeni gra...

NAZMIJA — Malit po luftojnë edhe gratë. Pas-

taj edhe ne këtu s'jemi pa burrë, jo. U rrit yt nip e im bir, Nuriu, u bë 13 vjeç dhe të ngjan ty, baba. Edhe fshati do të na gjen-det, s'do të na lënë vetëm, de.

KAJOJA — S'të bie asnjë fjalë për tokë, moj bijë, po ç'e do që na iku edhe Maliqi partizan, se më të do të ishit njëlloj si me mua.

NAZMIJA — Mos e ki atë merak, baba. Xha Maliqi vërtet iku partizan, po ai la shokët këtu. Si ai janë dhe ata. Pastaj më mirë unë përballë Pashos, se sa zotrote. Ai e di që ti më ke hequr mënjanë mua, kështu që dhe në e kërkoftë Bexhetin, do ta kërkojë këtu, tek ti, se tek unë s'i vete mendja kurrë. Le të kërkojë këtu, përmbys le ta kthejë shtëpinë, zjarrin le t'i verë, gjë s'ka për të gjetur. Këtu do më gjejë mua dhe dy nusët e tjera.

KAJOJA — S'më bëjnë këmbët, moj bijë, se si më vjen të lë tri nusët vetëm...

NAZMIJA — S'na ke vetëm nuse, por na ke edhe bija, edhe krah. Lerma mua në dorë këtë punë!

KAJOJA — *(Pasi mendon.)* E bërë qoftë edhe për hair na daltë. Veç, hap sytë, mos më turpëro! *(Pauzë.)* Fol dhe me tët kunata!

NAZMIJA — Me to do të bisedoj unë. Zotrote dhe nënë Sabikoja nisuni! *(Pauzë.)* Në konak kam edhe një tjetër, baba.

KAJOJA — Një tjetër, the? Ç'kërkon i huaji në shtëpinë tënde?...

NAZMIJA — Është im vëlla, Selimi. Zotrote e merr me mend pse ka ardhur, apo jo? Frikë mos ki, se e kam porositur. Tani nisuni dhe ji i qetë.

KAJOJA — Ika ika. *(Niset, errësim i plotë; pastaj ndriçim i zbehtë në dhomën e zjarrit. Natë. Nazmija shtrirë fle. Zjarri në vatër hedh pak ndriçim. Ndihen të lehurat e qenit, pastaj të trokitura të forta në portën e jashtme. Nazmija ngrihet ndenjtur dhe dëgjon. Trokitjet përsëriten më të forta. Hyn Neta e armatosur.)*

NETA — Erdhën, Nazo!

NAZMIJA — Mirë se të vijnë! Kokën e tyre do të hanë, qenat!.. *(Hyjnë Bulja me Nuriun të armatosur.)* Zini dritaret dhe siç ju kam porositur. *(Të trokiturat përsëriten më të forta e shoqërohen me thirrjet: «Hapni portën»!* Nazmija ndez kandilin, hap kanatin e dritares e flet). Kush troket, more?

ZËRI i I — A ka burra kjo shtëpi?

NAZMIJA — Ka shyqyr, plot... po ju ngadalë se tromaksët kalamajtë!

ZËRI I — E po në ka burra, s'ka pse të kakarisin gratë, po të dalin, se me ta kemi punë!

NAZMIJA — Jashtë i ke, malit, e meqë ke punë zotrote, shko e takoji!

ZËRI i II — Ata që ishin malit, i bëmë, të hamë dhe, por...

NAZMIJA — U morët të kegen!

ZËRI I — Moj, po do ta hapësh portën ti, apo si?!

NAZMIJA — Si the more?! Të hap portën?! Po pse ç'u bë kjo shtëpi, han u bë?! Thuaj njëherë kush je e çfarë do, pastaj kërko të të hapet porta.

ZËRI II — Jemi trimat e Pasho Pishës e kemi punë me Kajan Gurajn!

NAZMIJA — Nuk e njohim këtë Pasho Pishën tuaj dhe për trimëri s'ia kemi dëgjuar zërin as atij dhe as atyre që mban pas. Sa për Kajan Gurrajn ai s'ndodhet këtu. Ka shkuar në Bletas.

ZËRI II — Aty është, aty, po thuaj të dalë...

NAZMIJA — Të ishte këtu, s'priste t'i thosha as unë, as ti, po të kishe dalë që në trokitjen e parë. Këtu ka vetëm gra e fëmijë e ju, meqë s'keni punë me kakarisjet e grave e me lebetitjet e fëmijëve, shikoni punët tuaja dhe na lini rehat.

ZËRI I — E po mirë, meqë s'ka burra, mos e hap portën, po zbrit në oborr sa për të këmbyer dy fjalë. Të japim fjalën që s'të ngasim. Me besë. Ndryshe...

NAZMIJA — Nuk ta përfill as fjalën, as besën, por në oborr po vij, që të thoni ç'keni për

të thënë e të na lini rehat. (Ngjesh revolen në brez.)

BULJA — (E trembur.) Mos dil, Nazmije! Kam frikë për ty!

NETA — (E vendosur.) Lëre Nazmijen, se e di vetë ajo ç'bën! (E përqafton.) Faqebardhë, motër!

NAZMIJA — Faqebardhë të gjithë! (Del. Nriçohet vetëm paraskena në oborr. Nazmija del e i afrohet portës.) Fol, ç'kishe për të thënë? Po të dëgjoj.

PASHOJA — Nazmije, jam unë, yt atë, Pashoja...

NAZMIJA — E mora me mend, gjersa ishin edhe «trimat e tu». Ç'kërkoni?

PASHOJA — Hape portën sa të këmbejmë...

NAZMIJA — Portën nuk ta hap!

PASHOJA — Portën do ta hapësh se s'bën, por unë them ta hapësh me të mirë. Ndryshe, e shkallmova,

NAZMIJA — Akoma s'e ke bërë copë e çikë... Ç'pret?!

PASHOJA — Dëgjo këtu ti: unë që erdha deri këtu, do ta bëj timen, se s'bën, po puna ma do që në këtë derë ta bëj urtë e butë. Hape portën tani!

NAZMIJA — Të thashë që portën s'ta hap. Jam nusja e madhe e kësaj shtëpie dhe sonte që s'është as Kajoja, as e shoqja, mbaj mbi vete nderin dhe jetën e grave e të fëmijëve që janë brenda. Ç'kërkon më nga unë?! Hiqmu

dhe më lër rehat, në ke besuar perëndi!
PASHOJA — Mirë, moj, mirë, të drejtë ke dhe unë
të jap fjalë që asgjë e keqe s'ka për të ndo-
dhur brenda! Hape!

NAZMIJA — Qerimin e ke me vete?

PASHOJA — Jo, jo, hape se do të tregoj dhe për
Qerimin.

NAZMIJA — Nuk e hap, jo!

PASHOJA — (*Ballistëve.*) Shkallmojeni! (*Fillon
shkallmimi i portës.*)

NAZMIJA — (*Nxjerr revolen nga brezi dhe pret.
Porta shkallmohet e ballë për ballë vihen
ajo me Pashon.*) Prapsu! Dhe një hap përpa-
ra po bëre, t'i hodha trutë në erë! (*Pashoja
prapsët.*)

PASHOJA — Po ti ku vete, pastaj?

NAZMIJA — Në djall të vete edhe unë, po të të
vë ty përpara njëherë! Fol, tani, ç'deshe?!

PASHOJA — Ku është Kajani pse s'del?

NAZMIJA — Si ta merr mendja ty, të ishte kë-
tu, do të fshihej? Të thashë, iku bashkë me
të shoqen në Bletas te Hykallarët se i ka
vdekur i kunati.

PASHOJA — Hëm... Po ty të paska marrë prapë
në shtëpi, kështu?

NAZMIJA — Jo, jam atje ku kam qenë, po meqë
nuset ngelën vetëm, kishin frikë e më thi-
rrën. Tjetër?

PASHOJA — Demek, Kajani s'qenka këtu-ë? De-
sha t'i thosha nja dy fjalë ballë për ballë!

- NAZMIJA — Thuaji, se ia them unë dhe na lini rehat.
- PASHOJA — Prit se unë s'kam filluar...
- NAZMIJA — Po fillo, ç'pret!
- PASHOJA — Ku e fshehët Bexhetin?
- NAZMIJA — Ç'Bexhet, more?!
- PASHOJA — (*Ashpër*) Lëri ato, ti! Mos m'u hiq mua sikur s'di gjë?
- NAZMIJA — As e di e as po të marr vesh se për ç'Bexhët e ke fjalën.
- PASHOJA — Bexhetin, djalin e Rakip Çezmës. E vramë me duart tona që t'i zbardhnim faqen Kajo Gurrajt...
- NAZMIJA — Ej! (*Me ironi.*) Punë të bukur paskeni bërë! Tamam punë burrash! E pastaj?
- PASHOJA — E pastaj, ashtu të vdekur e solla këtu në avlli, që ta shihte Kajani e t'i ngopej xhani.
- NAZMIJA — (*Po me ironi.*) Edhe kjo s'ishte parë e dëgjuar. Po kur paska bërë vaki kjo?
- PASHOJA — Po po bën nja dhjetë ditë...
- NAZMIJA — Dhe pas dhjetë ditësh e kërkoni të vdekurin mbi tokë?! Jeni në vete?! Të vdekurin e çojnë vetëm në një vend, në varr. Ç'ma kërkoni këtu?!
- PASHOJA — Në fshatin tuaj s'ka asnjë varr të ri. Gjermanët dhe Isuf beu e kërkajnë prej nesh?
- NAZMIJA — Atëherë e kanë rrëmbyer bishat e korbata...

PASHOJA — Lëri ato, ti! Ai është i gjallë, po folmë ku e keni fshehur?!

NAZMIJA — Po ti e di që kjo derë as e fsheh, as e mbron atë. Shiko gjetiu, po jo këtu.

PASHOJA — S'kam lënë vend pa e kërkuar; po unë s'iki prej këtej pa e gjetur, të gjallë apo të vdekur. E solla vetë me duart e mia, ja këtu, në këtë oborr, e atë dheri s'e përpriu. Dikush e mori...

NAZMIJA — Po jo Kajan Gurraj...

PASHOJA — Po kush, atëherë? Thuama këtë dhe ika që tani.

NAZMIJA — Ta dija, do të ta thosha vetëm që të më hiqeshit sysh.

PASHOJA — Atëherë hap rrugën se do ta kërkoj vetë! (Niset.)

NAZMIJA — (I zë rrugën.) Prit! S'më the, ç'e bëre Qerimin?

PASHOJA — Qerimin?! Lëre-lëre o bijë! Më përveloi xhanë! E doja si evlatin tim.

NAZMIJA — (Ashpër.) Prandaj e le të shkonte për dhjamë qeni, të vritej nga larot e tu në pije e sipër?!

PASHOJA — Atë e vrau Isuf beu, moj bijë, se s'e duroi dot.

NAZMIJA — Po ti ti ç'bëre? Mbjajte sehir, se mos i prishej qejfi Isuf beut?!

PASHOJA — Lëre tani atë muhabet. Iku ajo punë...

NAZMIJA — Harrove që le tët bijë të ve me katër jetimë. Duan babanë ata... Dhe guxon e më vjen...

PASHOJA — E po lufta i ka këto... (*Niset të hyjë.*)

NAZMIJA — (*Ashpër.*) Prit të thashë! Ç'kërkon të bësh?!

PASHOJA — Do të kontrolloj, përmbys do ta kthej këtë shtëpi e pa gjetur atë s'e lë.

NAZMIJA — Që të më turpërosh e të më nxish mua, ë?! Prandaj do ta bësh këtë? Nga vetja na zvordhe edhe mua, edhe Selimin, turpin na e vure mu në ballë; tim shoqi ia prishe mendjen, dhe e katandise të lërë kockat pa nam e nishan; mua më bërë të ve, fëmijët m'i le jetimë, më prishe e më ndave nga njerëzit e burrit, tani kërkon të më nxish edhe faqen. Këtë kërkon ti? Bëje, Pasho Pisha, se edhe këtë kishe lënë pa bërë!

PASHOJA — Doemos. Nxirreni ose më thoni ku është dhe unë ika. Ndryshe, ujë të zi do të nxjerr! (*Niset.*)

NAZMIJA — Prit! (*E ndal.*) Meqë s'më përfille e do të më turpërosh, atëherë o shkel mbi trupin tim, o prano kushtin?!

PASHOJA — Pa, hë?! Thuaje kushtin!

NAZMIJA — Kjo është shtëpia e Kajan Gurrajt! Prapa janë konakët; ku rri unë. Edhe këtu, edhe atje, ka vetëm gra e fëmijë. Ti dhe larot e tu futuni, përmbysni ç'të doni, po e gjetët atë që kërkon, u vini zjarrin shtëpive,

dhe fëmijët e gratë që janë brenda, bashkë me mua, të digjen të gjallë. Por, ama, po s'gjetët gjë, ti i pari, Pasho Pisha, o hiqja vetes, o merr plumbin tim në ballë dhe pas teje dhe ca nga këta larot e tu s'dalin të gjallë nga kjo portë. Mos harro që janë afro 19 dyfeqe Gurrajsh dhe Drizash që dëgjojnë dhe përgjojnë e, midis tyre, edhe yt nip, Nuriu. Kushtin ta dhashë. Po e pranove, dyert hapur i ke. Futu!

PASHOJA — (*Disi i trembur.*) Kërkon edhe të më trembësh, ë?! S'ke faj ti, jo. Kur s'të solla gjermanin, pa e shihje ti pastaj. (*I afrohet Alush Agoja e diç i pëshpërit në vesh.*)

NAZMIJA — Gjermanin s'e solle jo se më ruajte mua, po lëkurën tënde, se ti e di se si do të pritej këtu gjermani e ai do të të vinte ty përparë.

ALUSH AGOJA — Lëre, o zoti Pasho! Gjersa s'ka burra, s'kemi s'i merremi me gratë.

PASHOJA — (*Tërhiqet.*) Atë thuaj. S'kemi ndër mend të bëhemi gazi i botës, jo. Pastaj, vete e të del përparë evlati, e gjer aty s'arrin dot njeriu.

ALUSH AGOJA — E ka thënë i moçmi atë fjalë, o zoti Pasho, «gjer në evlatin e këthehu pas!»

PASHOJA — (*Për justifikim*) Dhe mirë e ka thënë, se është edhe turpi, edhe dhembja. (*Ballistëve*) E, or trima, ç'thoni ju?

ZËRA — «Të ikim», «Kot që erdhëm»!, «S'ka të dyshimtë brenda, jo» «Nuk çohen me evlatin gjilpërat me majë!».

PASHOJA — Kur vjen Kajoja?

NAZMIJA — E vajtura dihet, e kthyerë jo. Po atje s'do të dimërojë. Këtu do ta kesh.

PASHOJA — Edhe mua këtu do të më ketë.

NAZMIJA — Mos e merr më këtë rrugë, o Pasho Pisha!

ALUSH AGOJA — Ikim, o zoti Pasho!

PASHOJA — Ikim, ikim! *(Dalin të gjithë. Nazmija mbyll portën me hekur dhe nisët për lart. Te hyrja i dalin përpara Bulja me Netën dhe i hidhen në qafë. Prapa tyre shfaqet Kajoja.)*

KAJOJA — *(Nuseve.)* Hapuni! *(I kap kokën Nazmijes dhe e puth në ballë.)* Trimëresha e babait! E mençura e babait!

NAZMIJA — Po ti baba, ç'ne këtu?

KAJOJA — Porsa erdha. S'më linte merak, bijë. Dhe mirë bëra. Sabikon e lashë atje. *(Afrohen Bexheti i plagosur me automatik në dorë dhe Selimi.)*

BEXHETI — *(E përqafton Nazmijen.)* Kisha dëgjuar shumë fjalë të mira për ty, motër, po më dole më e mirë akoma. Të lumtë! Veçse kushtin ia vuri një çikë të rëndë Pashos, sepse ajo farë s'ka besë.

NAZMIJA — Po ka frikë, ama. U dhimbset lëkura.

SELIMI — *(Përqafton të motrën.)* Mirë e bëre, mo-

tër. Asnjë s'dilte i gjallë prej tyre që këtej.
Kala do ta bënim shtëpinë e Kajan Gurrajt...
KAJOJA — Shkojmë brenda. (Të gjithë futen
brenda, Sipari.)

SKENA VI

Po ajo dhomë. Ka ardhur lajmi i vrasjes së Ganiut. Kajoja pret ngushëllime. Në dhomë ka plot njerëz, të tjerë hyjnë e dalin, takojnë e ngushëllojnë Kajan, i cili sipas rastit, u përgjigjet: «Miqtë shëndoshë!» dhe «Ju t'ju kem shëndoshë!» I nipi i Kajos, Idrizi, shërben. Ndihen të qara grash.

KAJOJA — O Idriz!

IDRIZI — Urdhëro, xhaxha!

KAJOJA — Çap andej matanë e u thuaj që s'dua gjëmë! Trimat nuk qahen po nderohen! Ashtu, më rrofsh! (Idrizi del.)

PLAKU I — Po si ndodhi kjo, o Kajan?

KAJOJA — Po si ndodhi de, hə. As unë s'e di. Pres të më vijnë djemtë.

PLAKU II — Luftë, o Seit, e lufta e shkretë i ka këto...

ZËRA — (Që miratojnë.) Ashtu është...

PLAKU I — Bëhu i fortë, vëlla, se s'je as i pari, as i fundit. Me shokët dhe ti.

- KAJOJA — Doemos...
- PLAKU III — Ishtë djalë trim.
- PLAKU II — Trim dhe i zgjuar. I kishte të rrallë shokët.
- KAJOJA — Si shokët dhe ai, o vëllezër.
- PLAKU III — Mirë thotë Kajani. Djemtë i kemi të mirë dhe trima. Luftuam me dy mbretëri dhe të dyjave u dhanë dërmën.
- PLAKU II — E çfarë dërme se. Me këtë dackë që hëngri gjermani këtë herë këtej, dhe në mos e theftë qafën, zor se e merr prapë këtë rrugë.
- PLAKU III — Jo, po, po desh, le ta provojë dhe një herë. (*Ndihen lëvizje.*)
- KAJOJA — Ç'është, more Idriz?
- IDRIZI — Po vijnë djemtë, xhaxha. (*Heshtje e plotë.*)
- PLAKU II — Djemtë duan zemër e atë do t'ua japësh ti, o Kajan, prandaj mbaje veten!
- NJË ZË — Të rëndë e ka i ziu. Iu bënë tre djem...
- KAJOJA — (*Reagon.*) Kush tha tre djem? Dy, or vëllezër, vetëm dy: Hysniu dhe Ganiu! Atë tjetrin e pata bërë hasha. Ai atë kërkoi e atë gjeti dhe mirë iu bë! Ashtu, de!
- PLAKU III — Mirë thotë!
- PLAKU II — Ashtu është vërtet. Atë që e bën hasha, nuk e numëron shqiptari, or jo!
- PLAKU III — Kështu, po si! (*Hyjnë Hyseni, Hamdiu, Maliqi etj.*)
- KAJOJA — Mbahuni, djemtë e babait! (*Ngrihet.*)

i takon, i përqafton, duke u thënë: «Ju t'ju kem shëndoshë». Takon e përqafton Maliqin etj. Djemtë i ulen pranë dhe nga hidhërimi e mbajnë kokën ulur.» Shqiptari, djema, e mban kokën ulur vetëm kur e mbulon turpi! Ashtu de!

HYSENI — Ke të drejtë, baba. *(Ngre kokën.)* Ganiu ra si trimat.

KAJOJA — Ashtu e desha dhe unë. Po, pa hë?

HYSENI — Më me hollësi e di xha Maliqi me Hamdinë, se ata iu ndodhën pranë.

MALIQI — Ja, të të them unë, o Kajo, pa shtuar e zbukuruar gjë.

KAJOJA — Fol, o Maliq, fol!

MALIQI — Ishte dita e fundit e luftimeve të këtij operacioni. Gjermani vetëm thyhej e tërhiqej. Ne po ndiq e godit. S'e linim as frymë të merrte. Te Shpella e Ariut që fortifikuar mirë laneti, e priste të grumbullonte forcat që të na kundërsulmonte e të na ndalte hovin. Po a mbareshin djemtë tanë se! «Do t'i shkulim edhe prej andej!» thoshin dhe secili donte të hidhej i pari. Nejse. U ndanë forcat. Hamdiut tënd iu dha porosi që me dy skuadra të merrte krahun e djathtë të Shpellës së Ariut. Me këto skuadra u futa edhe unë, Ganiu, Gjergji, Qazimi, Tasi ... e kush i mban mend. Filluam të ecnim zvarras. Në një krah ishte Gjergji, përpara, Ganiu yt në krah të tij. Më pas vinte Ta-

si e në krah të tij unë me Hamdinë tënd...
Kështu, o Hamdi?

HAMDIU — Kështu, kështu, xha Maliq!

MALIQUI — Mirë, po, s'mbahen këta të rinjtë, or jo! Ngrihet Ganiu yt në këmbë e pas tij edhe Gjergji. Bëj pesë gjashtë hapa vrap e shtrihu. Kur, ja përballë jepet një gjerman. Ganiu s'po e sheh që ai ka drejtuar armën, atëherë Gjergji hidhet dhe e mbulon me trupin e tij, në kohën që gjermani po shtinte. Asnjë s'po lëvizte: «Bobo, na i vrau djemtë!» thirra unë. Ganiu lëvizi pak. Në këtë kohë gjermani shfaqet prapë, po këtë radhë të tre ne, unë, Hamdiu e Ganiu, atë po prisnim, qëlluam njëkohësisht mbi të dhe e lamë top në vend. Afrohemi te djemtë dhe vëmë re se Gjergji ka mbaruar, ndërsa Ganiu ka marrë një plagë të lehtë në krah. «Më mbuloi me trupin e tij, pa shpëtova me kaq,» na thotë Ganiu. «I pamë të gjitha» i them. Në këtë kohë, nja tre katër gjermanë turren mbi Tasin. I shkuam në ndihmë, kurse Ganiu e lamë aty me Gjergjin. Mirëpo edhe Ganiu s'e lanë rehat. I bëjmë shenjë të tërhiqet dhe ai rrëmben Gjergjin në krahë e lufto e tërhiqte dhe në luftë e sipër ra edhe ai bashkë me Gjergjin. Ja, kjo është e gjitha. Luftuan si trimat e si trimat ranë të dy bashkë, duke mbrojtur njëri-tjetrin.

- KAJOJA — Mirë paskan luftuar, trimat e ba-
bait (*Djemve*) dhe ju, mos u mërzitni! Jemi
— të kësaj toke dhe po kësaj toke ia kemi borxh
edhe gjakun, edhe jetën! Ashtu de!
- PLAKU III — Bukur fole, o Kajan Gurraj...
- HAMDIU — Na dhe zemër edhe ne, baba.
- HYSENI — Gjersa zotronte qëndron mal mbi
hidhërimin, mal na ke edhe ne. Të rrojë
Shqipëria e lirë, baba!
- KAJOJA — Të rrojë e ta gëzojmë të gjithë!
(*Kujtohet.*) Mor bij, po komisari ç'u bë? Ma
donte zemra edhe atë sot.
- HYSENI — Këtu do ta kesh edhe atë, baba.
- KAJOJA — Të vijnë, or bir, të vijnë. Zemra ma
donte që e gjithë Partia të vinte sot këtu,
po kjo s'bëhet se ajo është e madhe e luf-
ton kudo.
- MALIQI — Këtu është edhe ajo, o Kajo. Të sajtë
jemi të gjithë. (*Hyn Idrizi.*)
- IDRIZI — Xhaxha, Hysenin dhe Hamdinë i kër-
kojnë përjashta. (*Të dy ngrihen.*)
- KAJOJA — Kush i kërkon, more nipçe? Pse s'ur-
dhërojnë këtu? (*Djemve.*) Pa shihni kush
janë e futini brenda njerëzit! (*Hyseni e
Hamdiu dalin.*) Ç'të jenë këta?
- MALIQI — Kush të dojë, derë e zemër hapur i
ke!..
- KAJOJA — Hapur, vëlla, hapur, të hyjnë! (*Kthe-
hen djemtë.*) Kush ishte, more djem?
- HAMDIU — Mëq, baba...

KAJOJA — Mirë se të vijnë, po t'i kishit futur brenda!

HYSENI — Këtu po vijnë, veç, zotrote, mbaje veten, tregohu burrë dhe bëju nderet sipas zakonit...

KAJOJA — *(Që nuhat.)* Mirë se të vijë, kushdo qoftë! *(Hyjnë njëri pas tjetrit komisari, Rakip Çezma, Selim Pisha etj. Lëvizje e pëshpëritje habie e të pranishmëve për ardhjen e Rakipit.)*

MALIQI — *(Ngrihet menjëherë.)* Të lumtë, o Rakip Çezma! E bërë si burrat!

RAKIPI — Jo mua, o Maliq, po Kajan Gurrajt i lumtë, se ai doli burrë mbi burrat!

KAJOJA — *(Pasi takohet e përqafohet me komisarin e Selimin, i zgjat dorën Rakipit.)* Mirë bërë që erdhe, o Rakip Çezma! Ulul!

RAKIPI — *(Ulet.)* Duhej të vija, ndaj të erdha, o Kajan. *(Të tjerëve.)* Unë solla zi në këtë derë, kurse Bexheti im jetën e dytë *(I drejtohet Kajos)* e ka nga ti e nga një-rëzit e tu. Ju e futët brenda, ju e strehuat dhe e mbrojtët, ju e mjekuat dhe e ngri-tët në këmbë... Faqe burrash, unë përulem para teje!

KAJOJA — Falur qofshin të gjitha, o Rakip Çezma!

RAKIPI — Qofsh i nderuar për jetë ti dhe shtëpia jote!

KAJOJA — Ndëre e të mira paç! (*Idrizit.*) O Idriz!

IDRIZI! — Urdhëro, xhaxha!

KAJOJA — Foli një çikë nuses së madhë. Të vijë këtu, së e dua! (*Idrizi del e ai të pranishmëve.*) Gjëra të mëdha bënë vaki në këtë luftë, o vëllezër! Vërtet u dogjëm, u vramë, po sikur u bëmë tjetër lloj. E ndiej që s'jemi ata që ishim. Si më të lehtë e ndiejmë veten! Diçka është flakur nga ajo barrë që na kërruste supet e na zinte sytë... Apo jo, o vëllezër?!

MALIQI — Fjalë më mend' fole, o Kajan Gurraj! Qe plug i rëndë dhe i thellë kjo luftë. Përmbysi shumë gjëra dhe i dha vlagën e duhur kësaj toke... (*Hyn Nazmija.*)

NAZMIJA — Më deshe gjë, baba?

KAJOJA — Të desha, bijë, të desha. Ka ardhur Rakipi e, doemos, ka mall për të birin, Be-xhetin. E sjellim dot këtu?

NAZMIJA — E sjellim, posi, baba, (*Matet të ikë.*)

KAJOJA — Prit. (*Rakipit.*) E sheh këtë, o Rakip? E bija e Pashos është vërtet dhe e shoqja e harramsëzit tim, po shpirtin tët biri kjo ia ktheu me zor. Qiri i ndenji mbi kokë natë e ditë.

RAKIPI — Bravo i qoftë dhe ia paçim borxh në dasmën e fëmijëve!

KAJOJA — (*Rakipit dhe të tjerëve.*) Edhe mua, o vëllezër, nuk e fsheh, më është gjendur ka-

luar djemve, duke mbrojtur nderin e saj,
timin dhe të shtëpisë simë.

RAKIPI — (*Nazmijes.*) Po eja këtu, moj bijë! (*Naz-
mija ulet pranë Rakipit.*) Djemtë e mi s'ka-
në motër. Tash e paskëtaj do të të kenë ty.
(*E përqafton.*)

MALIQI — Hë më të lumtë, o Rakip! Dhe të mos
ë kesh hiç pishman këtë që the!

RAKIPI — Ma desh zemra, pa ma nxori edhe
goja, o Maliq! Kisha dëgjuar të flitej mjaft
për këtë grua. Më kish hyrë në zemër. Ndaj
porsa e pashë e njoha; kjo është, thashë,
e reja e Kajo Gurrajt! (*Sipari.*)

Fund

Minarolli, Hamza

E reja e Kajo Gurrajt: (Dramë në dy akte) Hamza Minarolli; Red.: I. Nelaj.

— T.: Naim Frashëri, 1989, —. 88 f.; 16cm

891.983—2

M 78

Tirazhi 1000 kopje Formati 70x100/32 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK, Shtypshkronja e Re,

Tiranë 1989